

Zef Skiro Di Maxho është përfaqësuesi më i shquar i letërsisë bashkëkohore arbëreshe-shqiptare; poet, dramaturg, përkthyes, publicist. Di Maxho vijoi traditën epike të De Radës dhe të Darës, me kryetemat e tij: mbijetesa dhe jetesa arbëreshe.

ZEF SKIRO DI MAXHO:

Ruajtja e gjuhës
është elementi
kryesor i jetesës
arbëreshe

(fq. 2)



20 maji, Dita Kombëtare e Jetimëve

NUK DUHET VETËM NJË DITË

(fq. 7)

Nga ZHULIANA G. JORGANXHI

PËR DASHURINË E CASANOVA-S

Shënime udhëtimi

Mira Meksi

(fq. 6)

Ishte kohë udhëtimesh fluturake. Pranvera e prillit kur, nga një dëshirë e beftë, vendosa t'i bija Zvicrës kryq e tërthor, ishte e brishtë dhe lojcake....

Një biografi e re që hedh dritë mbi jetën dhe veprën e mbretëreshës gjermane Dada

MAMADADA

ELSA VON FREYTAG –
LORINGHOVEN

nga JUDITH LUIG


(fq. 16)

PAUL AUSTER: SI U TAKOVA ME SAMUEL BECKETT-IN

Atë pasdite, në "La Closerie des Lilas", do të veçoja më shumë një koment nga të tjerët dhe jo vetëm sepse na zbulon shumë Beckett-in si njeri, por flet për dilemën me të cilën duhet të jetojnë të gjithë shkrimtarët: dyshim i përjetshëm, paaftësi për të çmuar atë që ke krijuar".

(fq. 15)

Skicë nga Bujar Kapllani



Mbi librin "Kapitulli i Amerikës" të Fatos Kongolit

THJESHTËSI NË QËNDRUESHMËRI

nga Josif Papagjoni

(fq. 8)

Askush s'e di se si vezullon ideja e një vepre të re. Në çastin më të rëndë, që nga vdekja, ajo vjen si dritë shpëtimtare. Bash kështu i ka ngjarë Kongolit. ..

KADRI ROSHI – DASHURI E DEHUR

nga Xhevair Lleshi

(fq. 5)



Salman Rushdie

SHKRUAJ PËR LEXUESIT,
JO PËR KRITIKËT

(fq. 18)

BIBLIOTEKË

Nasho Jorgaqi

(fq. 10)

Dashuri e vonuar

Majlinda Rama

Pa strehë malli

(fq. 14)

Agron Bajraktari

Kadareja tjetër

(fq. 12)

Behar Jacaj

Zezonë

(fq. 13)

Shkrimtarët shqiptarë
në Amerikë

NË RRUGËN E NJË
TRADITE TË RE LETRARE

nga Adnan Mehmeti

(fq. 9)

Zef Skiro Di Maxho është përfaqësuesi më i shquar i letërsisë bashkëkohore arbëreshe-shqiptare; poet, dramaturg, përkthyes, publicist. Di Maxho vijoi traditën epike të De Radës dhe të Darës, me kryetemat e tij: mbijetesa dhe jetesa arbëreshe.


Zef Skiro di Maxho: Ruajtja e gjuhës është elementi kryesor i jetesës arbëreshe

Jeni nga emrat më të shquar të letërsisë moderne arbëreshe: poet, dramaturg, publicist dhe studiues letrar. A mund të na flisni për fillimet tuaja: poezia e parë, libri i parë...

Poezitë në fillim i shkruaja në gjuhën italiane. Një ditë të vitit 1964, pasi u kisha shkruar në Universitetin e Palermos për letërsi klasike, i solla një grumbull poezish në gjuhën italiane asistentit të Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, papas Matteo Sciambra-s; ky prift ishte edhe famullitar i kishës arbëroro-bizantine të Palermos, që quhet “La Martorana”, afër Universitetit. Papas Matteo Sciambra (1914-1967), autor i disa librave (*Mbi malin e trundafilet* – Palermo, 1963; etj.), sapo vërejti poezitë, më tha t’i ktheja arbërisht. Pasi kaluan pak ditë, e ritakova në famulli dhe i dhashë poezitë arbërisht. Ai u gëzua, se i pëlqyen. Më tha: “Lemi këtu se ja qell Atë Valentinit” – titullar i Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Universitetin e Palermos. Atë Zef Valentini i pa, i pëlqyen edhe atij dhe ia solli prof. Ernest Koliqit në një takim kongresual në Napoli. Ernest Koliqi i lexoi, i çmoi dhe i botoi në revistën e tij “Shejzat” (X, 1966 – 3-4). Kështu, pata tre nunë që më pagëzuan te pagëzorja e “Shejzave”. Kujtoj se pas ca kohësh rastësisht ndodhesha i pranishëm në çastin kur postieri i solli papasit Matteo Sciambra bustën me revistën “Shejzat”, në të cilën shkëlqenin bukur pesë poezi të miat. Ai lexoi prezantimin e redaksisë së “Shejzave” dhe pastaj tha me vete, o me mua: “Ky është moment historik!” Unë që kisha përvetësuar të gjitha shkrimet e Pirandello-s dhe lëvvoja filozofinë që buronte nga veprat e tij dhe e vija në praktikën e jetës, nuk qesha për nderim ndaj priftit, por tani që jam plak dhe më kujtohen fjalët e tij, mendoj se ndoshta papas Matteo ishte edhe profet. Ashtu zura fill të shkruaja arbërisht, më parë poezi në stilin e Ungaretti-t, që përshtatej mirë me arbërishten, sepse nuk nevojiteshin shumë fjalë për t’u shprehur, njëkohësisht shkruaja edhe rrëfime në mënyrën e Pirandello-s. Kështu fillimet e të shkruarit tim arbërisht.

Keni pasur një model në rrugën tuaj letrare? Nga letërsia arbëreshe, shqipe apo e huaj?

Për ne arbëreshët (italo-albanesi) letërsia italiane nuk është e huaj. Me atë jemi rritur dhe zhvilluar. Në fillim, thashë se në poezi ndiqja poetët italianë dhe në prozë e dramaturgj, sidomos, Verga e Pirandello. Letërsinë shqiptare, bashkë me atë arbëreshe, e njoha, si të gjithë studentët tanë, në universitet. Një ndihmë praktike në mësimin e gjuhës sonë na jepte që kur ishim fëmijë kisha arbëroro-bizantine me leximin e epistulave dhe tropareve. Ju shqiptarët jetën tonë në Sicili e mendoni si parajsa ku mbrohet gjuha, tradita e gjithçka ka të bëjë me arbëreshët. Nëse nuk do të ekzistonin njerëz të apasionuar në transmetimin e kulturës së fjalës, në mungesë të institucioneve, sot do të kishte qëndruar



vetëm kostumi kombëtar femëror që u flet syve, por nuk shpreh fjalë arbëreshe.

Malli për dheun e të parëve, pa dyshim, ju ka shoqëruar në jetën tuaj. Kur keni ardhur për herë të parë në Shqipëri?

Për herë të parë erdha në Shqipëri me rastin e Kongresit të 3-të të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë, në prill të vitit 1984. Ftesa nënshkruhej nga presidenti i Lidhjes, Dritëro Agolli, por ai që bëri të mundshme ardhjen time ishte profesori Nasho Jorgaqi, që para ca muajsh kishte vizituar trevat arbëreshe të Sicilisë e të Kalabrisë. Ia kam borxh profesorit sepse, pavarësisht nga mendimet politike që mund të kisha asokohe (si familje ishim demokristianë), më dha mundësinë të shikoja për herë të parë Shqipërinë, sipas dëshirës sime. Nga ndonjë i arratisur e kisha dëgjuar se Shqipëria ishte si e prapambetur në krahasim me standardet perëndimore, por mua më interesonte të shihja me sytë e mi Dheun e të Parëve. Kur u ktheva në Sicili, miqve që më pyesnin çfarë kisha parë u tregoja këtë e këtë dhe se të gjithë, gra e burra, kishin punë. Punonin edhe studentët, sidomos vullnetarisht: për shembull, për të hapur një vijë hekurudhore duhej të pritej ndysh një kodër, punën e mbaronin pas ndonjë jave. E këtu më përgjigjej duke qeshur miku arbëresh që më dëgjonte, duke më thënë se me një buldozer të vetëm për një ditë e gjysmë mund të sheshonte e di sa kodra. Më mirë të flisja për poezinë që shkaktonte Dheu i të Parëve! E për ndjenjat që të zgjonte me pamjet natyrore: male, fusha, lugina, liqene, brigje, kodra të krehura nga bujqësia, kanalizime ujërash të pijshme etj., etj., të gjitha të bukura e të mahnitshme. Dheu i përrallave më dukej arkadik, i lumtur pa masë, sidomos kur pashë parakalimet e 1 Majit 1984, që më bindën se kurrë marksizëm-leninizmi nuk do të shfarosej aty dhe ndryshe ndodhi, se u shfaros dhe tregoi të vërtetën e zbrazët të qenies së tij.

Lexuesit tanë ju njohin prej shumë kohësh nga vëllimet tuaja poetike, të botuara së pari në Kosovë (“Rilindja”): *Gjuha e bukës* (1981), redaktuar nga poeti Ali Podrimja, pastaj në Shqipëri: *Përtej maleve, prapa kodrës*, “Naim Frashëri”, Tiranë (1985), përgatitur nga studiuesi Nasho Jorgaqi. Ajo që bie në sy është botimi gati pesë vjet më vonë në Tiranë. A mund të na thoni se ku qëndronte vështirësia e botimit në Shqipërinë e para viteve ’90?

Libri me vjersha *Gjuha e bukës* u botua në Prishtinë më 1981, redaktuar nga Ali Podrimja. Besoj se nuk ka lidhje me hapësirën kohore prej pesë vjetësh me botimin tjetër *Përtej maleve, prapa kodrës*, përgatitur më 1985 nga Nasho Jorgaqi. Janë dy veprimtari të pavarura: njëra ndodhi në Prishtinë, tjetra në Tiranë. Asnjë vështirësi nuk më paraqitej për të botuar në Shqipëri. Isha unë që mendoja se sa shkruaja, ndoshta nuk ishte e përshtatshme me tendencat krijuese të poezisë shqipe në periudhën e monizmit. Nuk mund të shkruaja poezi për “Partinë”: te ne në Itali nuk lavdëroheshin partitë. Siç nuk shkruheshin poezi për krerët e Republikës Italiane. Unë kisha revistën “Mondo Albanese”, ku disa herë dëshiroja të botoja vjershat e ndonjë poeti shqiptar që kisha takuar gjatë udhëtimit tim të parë e të dytë (1985). Me keqardhje, në librat e poetëve shqiptarë nuk gjeja poezi të përshtatshme për lexuesin arbëresh, sepse ishin gati të gjitha lavdi për Partinë dhe për kreun e saj.

Më 1985 shkrimtari Nasho Jorgaqi përgatiti librin me poezitë e mia, *Përtej maleve...*, duke më thënë me gëzim: “I botova të gjitha!” Ndërhyrja e ekspertit shqiptar ishte e nevojshme. Komedia ime *Paja*, shkruar drejtpërdrejt arbërisht, u përshtat në shqip nga prof. Gjovalin Shkurtaç, me këshillat arbëreshe të poetit tonë Vorea Ujko. Përshtatja doli shumë mirë, sepse komedia mbajti shpirtin e saj arbëresh dhe u shfaq nga të shkëlqyeshmit aktorë korçarë të teatrit “A. Z. Çajupi”, aktor kryesor Pandi Raidhi, regjisor Dhimitër Orgocka. Më pëlqeu singërisht mua dhe shoqes sime, poeteshës Margherita Scilippa, që më shoqëronte.



Tiranë. Prill 1984. Kongesi i 3të i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Nga e majta: Muzafer Xhaxhiu, Nasho Jorgaqi, Giuseppe Del Gaudio, Ismail Kadare, Helena Kadare, Giuseppe Schirò Di Maggio, Vehbi Bala.

Në fondin e krijimtarisë suaj keni një varg vëllimesh poetike që ju kanë dhënë një emër të nderuar. Tema zotëruese e tyre është realiteti arbëresh, bashkëkohor dhe historik. Ju keni lëvruar jo vetëm poezinë lirike, por edhe poema me vlera të veçanta, siç është *Nëpër udhat e Parrajsit Shqipëtarë dhe t'Arbëreshë* etj. Po kështu zë vend në poezinë dhe teatrin tuaj fati i diasporës arbëreshe, siç del në veprën teatrale *Orëmira (Teatri im arbëresh – Tri vepra, botuar nga Ombra GVG, Tiranë, 2008, me parathënie nga prof. Josif Papagjoni)*. Cilat janë motivet më të preferuara të poezisë suaj dhe çfarë risie ka pësuar ajo vitet e fundit?

Natyrisht, kam shkruar vjersha dhe teatër për shpërnguljen e parë të arbëreshëve nga Epiri e nga Morea, por edhe për emigrimin e dytë të të papunëve drejt Europës së Veriut; në substancë ndjenjat janë gjithmonë ato shekullore për ne, *dhembja e dyfishtë* çdoherë: herën e parë dhe herën e dytë. Një vepër teatrale që më duket se është madhështore (si ata filma prodhuar nga "Paramount") – e them me bindjen objektive të autorit! – përveç *Orëmirës*, që trajton emigrimin e ri në tokat e pasura të Europës së Veriut, më duket se është botimi *Për tokën fisnike të Horës (Teatri im arbëresh – Tri vepra, Ombra GVG, Tiranë, 2008, me parathënie nga prof. Josif Papagjoni)*, që përshkruan shpërnguljen e parë, atë klasike, nga Epiro-Morea deri në Sicili.

Motivet e poezisë, si dhe të teatrit tim, janë të ndryshme: nga ato që na përkasin drejtpërdrejt neve si arbëreshë, deri në ato që i përkasin njeriut universal. Tani për tani jam si i bllokuar nga Platoni, që poetët i merr si njerëz të kotë e llafazanë.

Sapo kaloj këtë çast "filozofik", kam gati poezi të reja që kam shkruar, por pres çelësin, Platoni e quan "marrëzi hyjnore" (thëja mania) që hap mendjen për t'i shprehur mundësisht jashtë mjeteve tradicionale, sepse brendinë e kemi, por forma është ajo që duhet të dalë nga binarët e rëndomtë.

Letërsia arbëreshe është kryesisht poetike dhe mungon lëvrimi i prozës. Mbase i vetmi autor arbëresh që shkruan vepra në prozë dhe është afirmuar e vlerësuar nga kritika italiane dhe më gjerë me romanet e tij të suksesshme, është Carmine Abate. A keni një shpjegim për këtë?

E kam shpjegimin: gjuha italiane ka përmasa madhështore dhe 60 milionë lexues hipotetikë; gjuha arbëreshe është e kufizuar dhe të lexojnë, kur vete mirë, ata katër miq të vullnetshëm, që edhe ata ndoshta bëjnë sikur të lexojnë.

Por dua të flas për pohimin tashmë historik se arbëreshët nuk kanë prozë të shkruar arbërisht. Ky pohim duhet prishur njëherë e përgjithmonë.

Ju shtroj një pyetje: teatri i shkruar në prozë, cilës gjini letrare i përket? Natyrisht, prozës, jo poezisë. E di se kush ka shkruar për teatrin është shprehur edhe me vargje, por proza teatrale tani u përhap gjerësisht.

Flasim për prozën arbëreshe të botuar dhe jo, për shembull, për diskurse në prozë shkruar nga famulltarët tanë për të lëçitur komentin e ungjillit të së dielës (disa herë kryevepra për gjuhë dhe koncepte). I pari që shkroi, por nuk botoi, sepse botimi u bë në vitin 1984 shumë larg nga vdekja e tij, është F. A. Santori me dramën *Emira*. E vërteta është se dy aktet e dramës *Emira* u botuan në "Antologia Albanese" të De Radës dhe akti i tretë në revistën "Flamuri i Arbërit" (1883-1887). *Emira* është e para vepër zyrtare si prozë dhe si teatër. Unë kam shkruar njëzet vepra teatrale, ca të botuara me mjete modeste, ca të botuara bukur, dhe të parën *Dashuri magjike* e shkrova në fund të viteve '70 të shekullit të kaluar dhe e botova me mjete modeste në vitin 1982. Me atë botim aktorët dhe lexuesit tanë patën mundësi të shikojnë prozën e gjallë arbëreshe. Kështu del se i pari që shkroi në prozë qe Santori, i pari që botoi një libër në prozë qeshë unë në vitin 1982. Prandaj, nga viti 1982 ekzistojnë botimet në prozë arbëreshe. Kemi edhe prozën e bukur të Dushko Vetmos (Francesco Solano) në librin *Tregimet e lëmit* (1975).

Prozë janë tregimet e mia që kam botuar në revistat arbëreshe *Mondo Albanese*, *Katundi ynë*, *Biblos* dhe *Palimpsest*. Kam llogaritur mjaft tregime për t'i mbledhur si dyqind faqe të një libri. Por mungon romani arbëresh si gjini.

Për këtë do të shkojmë në letërsinë italiane, te romanet që flasin për arbëreshët, shkruar nga arbëreshë "di sola lingua italiana". Nëse ne pranojmë këtë diçiturë, kemi zgjidhur problemin e mungesës së romanit arbëresh. I pari romancier "di sola lingua italiana" ka qenë Giuseppe Bennici me *Un primo libro per mio figlio...* (1896).

Edhe unë kam një roman të pabotuar, me titull kuptimplotë *O mia bella Moorea*, kujdes se thashë



"Moorea", ishulli që ndodhet në Oqeanin Paqësor në Polinezinë franceze, ku arbëreshët kanë emigruar dhe kanë vazhduar pa pikë druajtjeje traditat dhe përdorimin e gjuhës në një mjedis fare të ri.

Më i miri shkrimtar italian "yni" sot është Carmine Abate, që ka pasur sukses në Itali dhe ne sinjerisht jemi gëzuar, sepse edhe ne jemi italianë. Tepër infantile të mendosh se jam "invidioso", se kam zili për Carmine Abate-n. Jo, nuk kam zili, siç nuk mund të kem zili për Giovanni Verga-n, për Luigi Pirandello-n, për Andrea Camilleri-n etj. O, për sa na përket neve, për Ismail Kadarenë. Flasim seriozisht!


Por ju ftoj të imagjinoni për një sekondë Carmine Abate-n që shkruan romanet e tij në gjuhën arbëreshe o arbëroro-shqipe. Suksemi është shumë më i vogël, natyrisht, sepse folësit dhe lexuesit arbëreshë janë një frymë para gjashtëdhjetë milionë lexuesish italianë, por më e lartë se çdo lartësi kozmike, më e gjerë se çdo hapësirë ndërgalaktike do të ishte lavdia dhe përjetësia e famës që do të lindte midis arbëreshëve për mot e monë! Një herë Carmine Abate më tha se gjuha arbëreshe nuk ishte gjuha e fëmijërisë së tij dhe se ajo italiane përshtatet me krijimtarinë e tij. Mirë. Ai ndihet arbëresh, megjithëse shkruan në gjuhë italiane. Për shqiptarët vete mirë. Sepse shqiptarët sapo dëgjojnë se, për shembull, aktori akëcili (pa bërë emra: Bellusci) dëfton nga mbiemri prejardhje shqiptare, e vendosin në altarin e famës së përjetshme si gjiri i tyre. Edhe për presidentin Trump ndonjë shqiptar thotë se ka prejardhje shqiptare dhe mburret sikurse janë bij motrash. Kështu që duhet t'i nënshtrohemi mendimit se, edhe nëse shkruan në gjuhë italiane, Carmine Abate është shkrimtar arbëresh. Si Tagore që mbeti poet indian, megjithëse shkruante në gjuhë angleze. Si shumë shkrimtarë dhe poetë që ndërruan gjuhë kur u larguan nga vendi i lindjes. Mirë!

Mbani mend, nga kjo përsiatje, se gjuha italiane zë pjesën kryesore të kulturës dhe shprehjes së përditshme të arbëreshëve. Arbëreshë, mos ngatërroni mesazhin se vetëm kush shkruan në gjuhë italiane fiton suksesin! Por, në do suksesin, shkruaj në gjuhë italiane!

Dhe ata që kanë kërkuar t'i japin shkëlqim arbërishtes, kanë gabuar? Kush e tha se duhej të kërkonin suksesin në vend të dëfrimit, të lartësimit shpirtëror dhe të gazit të arbëreshëve që të kanë ndjekur.

Pas shumë dekadash kërkesash e pritjesh nga komuniteti arbëresh, më në fund, shteti italian e njohu zyrtarisht statusin e tij, gjuhën amtare, shkollimin arbërisht, financimin në fusha të ndryshme etj. Një ngjarje kjo historike për komunitetin tuaj dhe që shënoi progres të gjithanshëm për diasporën arbëreshe. Cilat janë ndryshimet në jetën tuaj dhe në fushën e kulturës pas kësaj ngjarjeje jetike?

Në jetën time nuk ndryshon asgjë. Kam punuar falas me pasion, siç kam punuar me pasion kur ka ardhur



ndonjë kontribut publik. Edhe fakti se shteti italian ka njohur minorancat që jetojnë në të enfatizohet shumë, sikurse nga ligji për pakicat do të ndryshojë situata. Zakonisht, kush interesohet për financime, nuk interesohet për progresin dhe për ruajtjen e gjuhës që, sipas meje, është elementi kryesor i jetesës arbëreshe. Besoj, me kaq, se kush pret financimet shtetërore që të fillojë të interesohet për problemet efektive të arbërishtes, do të jetë shumë i kënaqur.


Në kuadrin e gjuhës dhe mendimit të lirë keni pasur një numër të konsiderueshëm gazetash dhe revistash arbëreshe. Dhe ju vetë keni botuar dhe drejtuar revistën “Mondo Albanese”. Por, për dijeninë tonë, këto organe nuk dalin më. I vetmi organ që vijon të dalë për afro 50 vjet është revista “Katundi ynë”. Si shpjegohet kjo situatë?

Ajo revistë o gazetë arbëreshe që do të jetojë, detyrohet të dalë në gjuhën italiane që të shumëzohet numri i lexuesve. Ka pasur revista në mes të arbëreshëve, por, përveç asaj që përmendët ju, d.m.th. “Katundi ynë”, të tjerat kanë pasur fat dhe zhvillim të shkurtër. Edhe revistat antike të drejtuara nga letrarët tanë të mëdhenj kanë zgjatur pak: mendoni se “Arbri i ri” i Zef Skiroit (1865-1927) pa dritën vetëm tri herë në tre numrat e saj.

Revista “Mondo Albanese” lindi për lodër, d.m.th. për të bredhur (shqip: luaj) me të shkruarit arbërisht, dhe megjithëse ballina dilte në gjuhë italiane, për kundërshtim, kush shkruante, ishte i detyruar të përdorte arbërishten. Numrin e fundit e botuam më 2009. Por sot “Mondo Albanese” jeton në Facebook: kërkoni “Mondo Albanese – Shkruanj urtësisht përgjithmonë arbërisht” dhe gjeni ndonjë gjë interesante. Në web del edhe revista “Jeta arbëreshe” nga Ejanina, por çdo gjashtë muaj.

Nga komuniteti juaj kanë dalë poetesha të talentuara, si Enca Skutari, Matilde Ferraro etj. A mund të na flisni për krijimtarinë e tyre?

I njoh këta emra dhe njoh të tjera gra që i janë kushtuar poezisë në gjuhë. Por nuk di të flas për krijimtarinë e tyre dhe si unë nuk dinë të flasin arbëreshët e Sicilisë. Për Kalabrinë nuk e di në ka kritikë të kualifikuar. Problemi është se nuk ka “shkollë” që të mëson kush janë ato. Nga ana tjetër, fare pak janë poeteshat arbëreshe në Sicili që kanë pasur mundësi të botojnë vjershat e tyre. Njoh për shkaqe familjare poeteshën Marg Shilipa (Scilippa) që ka botuar dy libra të dendur me poezi dygjuhëshe këtu në Palermo dhe një libër-antologji në Tiranë me titull Ëndrra si re tek Ombra GVG në vitin 2015. Ka poetesha të tjera në Horën e



Arbëreshëvet dhe poetesha në Kuntisë (Contessa Entellina) që kanë shkruar arbërisht.

Ju jeni edhe dramaturg i njohur dhe keni drejtuar edhe teatrin e Horës. Një komedi juaja është vënë në skenë edhe nga teatri “A. Z. Çajupi” i Korçës, siç keni botuar në Tiranë një përmbledhje të poemave tuaja *Poema arbëreshe (Poemi arberischi)* nga kolegu im, botuesi i Ombra GVG. Cilat janë tashmë lidhjet tuaja me Shqipërinë dhe a keni projekte për të ardhmen?

Ajo komedi e shfaqur në Korçë quhet *Paja*. *Paja* u bë edhe balet dhe u shfaq në Teatrin e Operës në Tiranë, me përshtatje të poetit Sulejman Mato dhe muzikë të maestros Nikolla Zoragji.

Një komedi tjetër me titull *E fejuara fantazmë*, nga origjinali *Shumë vizita*, u shfaq nga aktorët e teatrit “Bylis” të Fierit, regjisor Roland Çaka.

Gjithë këto raste nuk i shfrytëzova për të mbajtur raportet me këta artistë të shkëlqyeshëm. E sot pendohe. Ndryshimin e regjimit në Shqipëri aty në fillim të viteve '90 e përjetova si katastrofë, e duhur, patjetër, por tepër shkatërruese për mua që kisha parë “lumturinë e rreme” të shqiptarëve.

Në vitin 2007, me parathënie të Nasho Jorgaqit, Ombra GVG më botoi një antologji poetike të bukur jashtë dhe brenda, *Ishuj*.

Në vitin 2018, në Panairin e Librit të Tiranës, *Poemat arbëreshe (Poemi arberischi)* – Ombra GVG – mori çmimin e veçantë të Shoqatës së Botuesve.

Them edhe se pas tridhjetë e nëntë vjetësh botova një libër në Prishtinë për nderim të poetit të shquar Ali Podrimja, me titull *Ali Podrimja, njeriu pa adresë* – “Faik Konica”, Prishtinë, 2019.


Megjithëse si ca i moshuar, kam një mijë ide për të vënë në praktikë: botime e botime. Kam të botoj gjithë teatrin, njëzet vepra; kam të botoj vjershat e reja e të ribotoj të vjetrat; kam të mbledh e të botoj rrëfimet e mia; ndoshta do të botoj edhe romanin tim të vetëm shkruar ca arbërisht e ca italisht etj.

Si paraqiten marrëdhëniet e shkrimtarëve arbëreshë të Sicilisë me ata të Kalabrisë? A ekzistojnë shoqata letrare që zhvillojnë veprimtari krijuese dhe kontribuojnë në letërsinë e përbashkët?

Arbëreshët janë të gjithë të ndarë. U hyn lufta për pushtetin kulturor, por edhe natyra e egër e individualizmit. Shqiptarët nuk e di. Por arbëreshët po. Aq sa një profesor i njohur kalabrez propozoi një shoqatë me këtë parullë: “Bashkë jemi më shumë!” Kur lexova parullën, shtanga. Si nuk mund të bashkohemi kurrë? Si të thuash bashkojmë individualizmat. Në Horën e Arbëreshëvet, p.sh., jemi të gjithë të ndarë. Kështu që propozova një shoqatë më të përshtatshme me situatat tona: “Të ndarë jemi më shumë!”

Cilat janë lidhjet dhe kontaktet në ditët tona mes letërsisë shqipe që zhvillohet në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni etj.? Ju personalisht çfarë raportesh keni me kolegët tuaj sivëllezër? Sa njihet nga lexuesi krijimtaria e dy palëve?

Njihet pak o njihet e kufizuar. Nëse, për shembull, ti boton një libër më 1981 e miku poet lexon po atë libër, sepse objektivisht s’ka mundësi të ketë librat e tjerë që ke botuar deri më sot, sa e njeh ai poezinë tënde? Por kemi, si të thuhet, njerëz të ndritur që favorizojnë njohjen e ndërsjellë, me takime poetike dhe me botime të antologjive. Unë udhëtoj pak, prandaj e jashtëzakonshme ka qenë prania ime në mes të poetëve dhe poeteshave në Tiranë, Korçë, Ulqin, Tetovë, Sarandë. Poetët dhe shkrimtarët që kam takuar nuk i përmend këtu, sepse druaj të harroj ndonjë emër, por i kam miq të mirë. Tani me Facebook kemi mundësi të takohemi kur të duam.



KADRI ROSHI – DASHURI E DEHUR

nga Xhevair Lleshi

Ezeza, Karabashta e famës së jashtëzakonshme të aktorit tonë të madh Kadri Roshi, na përmbyti me një brizë të hollë sikur do t'na shponte brinjët. Si flinte ai? Ne e patëm lënë dhe ai do të duhej të na priste. E ndjemë se qe zgjuar dhe u vërsulëm brenda. Gryka e gjerë drejt kanalit hijezoj dhe bëhej gati të derdhej hijerëndë në det dhe do të trysej ëmbël dhe kripur një gjatësi të fjetur. Janë ujëra të çuditshme këto, si ajkëtuar i kripur me sheqer. Ujë të tromaksur e të përzierë si ia kishte qejfi bënte edhe ai një sy gjumë të tronditur para takimit me hapësirën që e priste në muzgun e detit të mërzhitur s'di pse. Vetë Karabashta, *Bashhtëzeza*, shihte ëndrra bojë trëndafil dhe puthej me hijet levarashe të pyllit të atëhershëm të Divjakës, tretur në hapa murgjish të ardhur apostafat për të parë pikërisht këto puthje të mrekullueshme. Duket këto shihte edhe Kadri Roshi. «Erdhët?» pyeti. «Erdhëm, po verë nuk kemi!» Nënteksti i asaj që nuk u tha, u ndje. Këtu s'mund të vije pa verë e pa femra!

«Do ta lëshojmë varkën?» pyeti Llazari, i tymtë, i thatë dhe gjithnjë ngacmues. Sheri Mita qeshi me zërin e tij të jashtëzakonshëm, të ngrohtë e të dashuruar. Varkëtari doli nga ferrat atje tej me një shufër të gjatë për t'u nisur me ne. Na dëgjoi dhe erdhi. S'donte ta thërrisje. Themiu ishte gjuhëprerë. Kurrë nuk ia dëgjua zërin. Po pyesnim me sy njëri-tjetrin, se mos ia prishëm planin. «Jo, mos mendoni ato që çoni në mend. Nuk më keni prishur asgjë. Ia kam prishur vetes... Vetes ia bëjmë gjithnjë të zezën... Hija e saj më ndjek gjer këtu. Dhe unë flas, qesh, këndoj me hijen e saj!...» «Me hijen?» e pyeti Sheri serioz. Kadri Roshi po mbyste të qeshurën me një tingëllim pendese, duke e tundur zërin përbrenda, si zilka të argjendta që do të mbyteshin në ujë duke ndjekur varkën e Themiot memec.

Shufra e gjatë e Thimit bëri një hark nga pas dhe u ngul fort në ujë, i cili u turbullua. Më pas e nxori bashkë me një ngjallë të stërmadhe. Ajo, e mjera spërdridhej dhe Kadri Roshi e kapi me një qeshje të madhe e të hapur në fytyrë. E plasi mbi dërrasat e varkës dhe atje ajo përdridhej si gjarpër nëpër këmbët tona. Sheri nuk po e duronte fare. «Ah ta piqnim këtu!» belbëzova. «E pjekim më mirë mbi ujë!» E qeshura e tij u zgjat mbi vijën e ujit. «E dini? Këtu do t'i sjellin pleqtë, në pyll, me kuajt hergjele, para se të vdesin. Sa në varka, sa në pyll. Do të ngrenë edhe një kishë, shshsht, do t'u bien kambanave pleqtë, do të falen për shpirtin e tyre, do mbeten pastaj lakuriq, do mblidhen me fiere e me shpëndra dhe do kërcejnë si qëmoti, duke harruar se kamerat do jenë 24 më 24 dhe do t'ua japin bijve t'i shohin etërit e marrosur e të tretur nga malli. Unë për vete këtu do të doja të më sillnin. Pleq e plaka. Kënga e erës, e detit, e pyllit dhe e Karabashtës do të bëjnë korin më të bukur në botë. «Ej, djalë, e kam vërtet. Nuk po tregoj përralla. Se unë flas dhe qesh me hijet, po nuk shoh ëndrra me sy hapur kurrë! As kur dielli është më të perënduar. Janë njëqind e tridhjetë e gjashtë konakë kashte e degësh dushku në këtë pyll Divjake, nëpër këto kodra halli», tregoi ai duke hapur krahët mbi varkë. Aktori i madh hoqi thellë. «Natën këtu në pyll s'ka frymë njeriu. Kullosin kuajt hergjele, kullosin delet e dhinë, lopët, ulërijnë ujërit e çakejtë, aq sa i zë tmerri edhe peshqit! Ah, moj e poshtë, pse më ike! Dhelpra. Sheri, ju s'e merrni dot me mend se si më rrinte. Sus!... Mendoni pleqtë peshkatarë, tharë në tym si dru thane, duke u marrë me veten, vreshtin e madh të ëndrrave, ujërit dhe verën...» Po fishkëllente Themiu dhe ia kthente era e butë e Karabashtës...

Kasollet e eremitëve. Të isha si ty djalosh një roman do shkruaja për to, për femrat e tyre që vinin në muzg dhe largoheshin në mugëtirë. Ah, sa e ëmbël që është, Zot, mugëtira! Eremitët deheshin me zjarrin e femrave të kolme dhe batisnin dheun e kuq ku rriteshin lisat e Divjakës. Nga halli kapërcenin Kanalin e Gjerë të Detit dhe e mbanin frymën në Ardenicë. Lukunia e tyre atje është, në Ardenicë. Keni hyrë aty ndonjëherë? T'i merr flokët Fryma e Detit.

Qan era me zë femre dhe tremben ata që shkojnë andej, përpara manastirit të vetmuar që kuqëlon nga Perëndimi. Këto kasolle kanë hequr të zisë e ullirit. Këtu i groposnin në kashtë shalqinj të myzeqarkat dhe vendet i dinin mirë djemtë e hedhur që u binin pas mëzatkave! Themiu dridhte fishkëllimën dhe puhiza e mbrëmjes i mbante kaba. Një goditje tjetër me shtagën e gjatë që harkohej mbi kokat tona. Ishte e katërta ngjallë...

Nata po hapej si e ndarë më dysh, duke davaritur re pluhuri dhe tymi nga buza e pyllit. «Si ia bën me gjarpërinjtë, mjeshtër?» «A, me gjarpërinjtë është ç'është, Themiu e di.» Ky thartoi turinjtë dhe shihte tinës nga Kadri Roshi. U bën magji Themiu. Eh si vallëzon me ta! Po ç'vesh muzike që kanë! Ç'të të them, vëllezër! Është çudan njeri ky! Dhe, pale, pale, po ky dhe puthet me ta. Lozin, mo, lozin gjarpërinjtë me trupin e Themiot. Po kur vjen Dhelpra, naze të mëdha luhen. I do djalli, i do... Papritur ujërat e Karabashtës u tundën dhe toka po oshtinte thellë. Kuajt! bërtiti Kadriu dhe u përngreh. Ku vinin gjarpërinjtë? M'u bë sikur pyeta dhe sytë u larguan tutje te ca rosa e çafka, me këmbë të penguar prej ujit, plot trille levarashe, pastaj mund të shihje pelikanët madhështorë të vargosheshin hijerëndë...

E di ç'thonë eremitët e panjohur (edhe Dhelpra natyrisht!) kur ia behin kështu kaq dendur miqtë e paftuar? Vijnë, thonë, se e ndiejnë aromën e femrës. Është një bar këtu në Divjakë e në brigjet e Karabashtës që ta bënë kokën tym dhe shpirtin dyst prej kësaj arome. Madje edhe ujqit mbeten gojëhapur dhe meshkujt u shalojnë kuajve të egër, si të paudhë që janë dhe jo vetëm njëherë, po sa herë të duan, dhe fluturojnë tutje, larg bashkë me ta e me to... veç kur i gjenin shtrirë mbi rërë, buzës së zbaticeës.

Sa nuk u mbytëm nga e papritura e thirrjes së Dhelprës. Mos u trembni, tha Kadriu dhe doli. Edhe ai imitoi Dhelprën. Iku. S'e ktheu kokën prapa. Ne të tre kishim punë me ngjallat e pafundme, me verën allasoj, të kuqe flakë dhe me një aromë shafrani të patreguar. Do t'i ketë shtruar manxuranë

ky i flamur Themiu kasolles së re të Kadri Roshit? Jo? Po atje të shqyejnë gjarpërinjtë. He-he, po hyri Dhelpra, miku im, ikën gjarpri. Nuk e duron dot aromën e femrës ky budalla i frikshëm. Ku e lë Kadriu atë? Se ky i uruar është bërë eremit dhe firar. E dëgjon? Po vjen më duhet. I bëri fërtele gjunjët me hijet e natës! S'la Dhelprë dinake pa futur në shtrungë. Pse, futen edhe Dhelprat në shtrungë? S'e kisha dëgjuar... Nata lëvizte me zërat e saj të fshehur me një mister të padukshëm. Herë pas here vinte së largu troku i kuajve hergjele... Më në fund u ndje kolla e Kadri Roshit. Basi i Sherit e shkundi kasollen. Kadriu i gjatë dhe i holluar përkuli kokën dhe shtyu lesën. Seç belbëzoi diçka nëpër dhëmbë. Hë, mo, i trembe, apo të frikësuan lanetkat! Zot i bekuar, ajo është nga këto shtojzovallet e pyllit nakatosur me të detit, sirene. Dhelprë, jo llafe. S'di as ku ta afrosh, herë është ajër, herë është dritë, herë të tjera nxin. Ç'të të them! Nuk tregohen ato të sajat. Vdes i ziu njeri për t'u dashur, trokë bëhet. Po ajo s'pyet. Gafron, të çjerr si mace, pastaj kthehet në kotele, thotë fjalë të ëmbla, bëhet hije...

U dëgjua edhe hapat e Thimit. Tërhiqte bran rrjetat deri te varka. Një kollë e thatë shponte natën e kthyer për nga mëngjesi. E qeshura e Thimit të mbante pezull e si në pëllëmbën e dorës. Mjekra e tij frizohej nga fryma e Karabashtës. Ç'thotë ky, mendoja, çfarë sheh, që mua s'ma zënë sytë? Fliste me vete, i drejtohej ujërave, pyllit, kuajve. As kuptohej se ç'katranoste tjetër ai! Edhe Kadri Roshi kishte ngrirë herek në mes të kasolles. Bënte punë të rëndë ky njeri i madh. U fliste njerëzve nga skena! Zoti ta ndihmonte! Bënte kryq pa e kuptuar, gjente prapësitë e fundit, llogariste me mend mëkatin e radhës... «Qenke akull», i tha Sheri Mita. Mugëtira po hapej duke shembur vende-vende pllanga të përhimë si cerga të tymosura merimangash të zeza. Dukej se ishin zhdukur dhe frymët e vdekura rreth e qark nganjëherë sillen në ajrin e qiçërimtë. U dëgjua përsëri një përngjasim i thirrjes së Dhelprës. «Po kjo?» pyeti Sheri me të qeshur. «Erdhi prapë, duket. U bë esëll. Zot i madh! Po ma merr frymën dhe prapëseprapë do të shkoj. Ma bëj hallall Sheri, për këtë pritje! S'e kisha menduar. Dhelpra ime është e paturpshme!...» Ngriti duart lart dhe thirri me zërin e tij si me lebeti të kobshme. Ishte i veçantë ta bënte këtë. Askush nuk mund t'i afrohej. «U pa puna, ajo do t'më marrë në qafë. E ç'e doni, harrojeni, por unë s'mund ta harroj dot...»

Iku, pa thënë më një fjalë. I thirrëm, Kadri, ku po shkon... Kadri, eja, po vjen mëngjesi edhe ne do largohemi! Po ai iku, ja, atje në gjirin e natës, nuk e pa më askush, vetëm në mëngjes do ta gjenim në kasollen e parë të eremitit. Ishte në gjumë me Dhelprën e tij, krahaqafë. E lamë pas kasollen e Kadri Roshit që ndërkaq po na humbte nga sytë...



PËR DASHURINË E CASANOVA-s

Shënime udhëtimi
Mira Meksi

*“Ajo që dëshiroj më shumë në këtë jetë,
është të trem e të humbas në shpirtin e
gruas që dashuroj”
- Giacomo Casanova*

Ishte kohë udhëtimesh fluturake. Pranvera e prillit kur, nga një dëshirë e beftë, vendosa t’i bija Zvicrës kryq e tërthor, ishte e brishtë dhe lojcake. Kishte ditë kur vezullimi i qiellit jepte sigurinë e njëmendtë se dimri kishte dalë përgjithmonë. Porse të tjera ditë, fërfëlliza e dëborës e bënte të largët kujtimin e pranverës. Vendqendrimi im ishte Berna dhe udhërrëfyesi, im bir që asokohe jetonte në atë qytet. Që aty, pothuaj çdo mëngjes, nisesha me të për në vendet turistike që përzgjidhja kuturu në libërthin turistik, për t’u kthyer natën vonë, e rraskapitur dhe e mbushur me gëzimin naiv të zbulimit të bukurive të natyrës dhe qytezave mesjetare me kështjella dhe monumente kulture. Dhe sërish më mbetej lakmia për të njohur të tjera bukuri dhe vlera gjatë ditës së re, sa më shumë zbuloja të atilla vise magjike , të cilat në gjuhën turistike quhen “të pashmangshme”. Nuk ishte e zakonit për mua. Sa herë udhëtoj e kam të përcaktuar mirë atë që dua të shoh dhe që, në të shumtën e herës, është objekt i një studimit tim të hollësishëm. Porse pikërisht lehtësia e ëmbël e asaj jete prej turisteje të shkujdesur, ndonëse e huaj për mua, po më çlodhte nga tensionimi i pazakontë që më pat sjellë shqipërimi i një vepre të madhe të letrave universale që më kish marrë një kohë të çmendur...

Gjeneva ishte e pashmangshme në itinerarin turistik. E pashmangshme në Gjenevë, vizita në varrin e Borges-it. Nuk ishte vizita ime e parë në varrin e shkrimtarit të botës që e kisha shpallur me kohë mjeshtrin tim të shkrimësisë. Porse “Qimiteri i mbretërve” sërish më mrekulloi me pamjen e tij të jashtëzakonshme prej një kopshti të selitur që lulëzonte që nga Mesjeta e largët.

Poshtë një peme të madhe bërsheni, simbol i përjetësisë së shpirtit, në numrin 735, mes qetësisë dhe 300 të vdekurve të shquar, prehej Jorge Luis Borges-i që në vitin e largët 1986. Varri i tij thjeshtan ka vec një gurëkoke ngjyrë hiri ku është gdhendur emri në formë harkore, së bashku me vargje të sagave nordike, si edhe një shtrojë prej shkurresh të vogla, përherë të gjelbëruar. Kësaj here guxova edhe të shkruaja emrin tim përmbi një petashuqe guri, siç kish bërë shumkush para meje dhe ta vendosja përmbi kokëvarrin e tij, edhe të merrja një grusht dhé për të mbjellë karafila në saksi...

Porse në një kafene aty pranë, ndërsa gjerbja një kafe shqeto dhe shfletaja prospektin turistik që ndodhej përmbi tryezë, sytë më mbetën te një emër, Versoix. Brenda një grime kohe, tërë Kujtimet e princit venecian të dashurisë, Casanova-s, të shkruara në disa mijëra faqe nga dora e tij, që i kisha lexuar në tetë volume përgjatë dy vjetëve, u plasën si male dallgësh mbi mua. Mbeta si e goditur në vend, si përpara zbulimit të një qëllimi të madh, sepse kuptova që ai udhëtim ishte bërë pikërisht që unë të shkoja në Versoix, aty ku Henriette-a, dashuria e

jetës dhe e vdekjes së Venecianit, kish lënë gjurmën e ekzistencës së saj. Casanova dashuroi shumë gra, bëmat e tij dashurore të përshkruara me hollësi në Kujtimet që shkroi, i dhanë emrin “artizani i seksit” dhe legjenda u thurën për “ngashnjyesin e madh”apo “mjeshtrin e erotikës”. Megjithatë, Kujtimet e Venecianit, të konsideruara si enciklopedia e shekullit XVIII, kullojnë nga dashuria e përjetshme për Henriette-n. Legjenda veneciane tregon se pasi Casanova zbuloi ujin e rinisë së përjetshme, ai jeton në jetë të jetëve dhe në vdekje të vdekjeve me Henriette-n e tij... Sado që shkroi shumë për të, madje edhe kur nuk e përmend me emër, Casanova e mbuloi me një mjergull të trashë misterit identitetin e vërtetë të gruas së zemrës, kurrë nuk e zbuloi emrin e saj të plotë, aq sa disa biografë të tij në zë hedhin dyshime për vetë ekzistencën e saj. Njëlloj siç dyshojnë në vërtetësinë e disa fakteve dhe ngjarjeve të tjera në veprën e Casanova-s.

Sipas *Kujtimeve*, ai e takon Henriette-n në një bujtinë në Cezana, aty rreth vitit 1749. “Ishte veshur si burrë dhe ndodhej në krahët e një oficeri hungarez, i cili dinte vetëm gjuhën e tij. Ishte pinjolle e një familjeje fisnike franceze të Provence-s, aventuriere që jetonte në arrati, për shkak të familjes që kërkonte ta dorëzonte murgeshë. Bukuria e kësaj vajze më robëroi në çast”, shkruan Casanova. Ajo duhej të ishte pak më e madhe se ai në moshë, e regjur në aventura, e rrethuar nga një mister magjepsës, ndërkohë që veneciani ishte vetëm një rishtar aventurier. Henriette-a është shpirti i tij binjak, një grua që si ai, e ka marrë vetë në duar fatin e saj, është dubli i tij femëror, dhe pasioni i dashurisë i moleps për vdekje që të dy. Ajo i mëson shijen e aventurës. Është dashuri absolute. Nisin jetën e përbashkët, tanimë vajza vishet me petka të mrekullueshme femërore, nga aventura në aventura nëpër Itali për muaj me radhë, duke ushqyer me gjakun dhe shpirtin e tyre një dashuri sa vetë universi. Giacomo i shkon pas francezes në arratinë e saj. Henriette-a është e edukuar, e kultivuar dhe shijehollë, e zgjuar e me humor dhe adhuron, njëlloj si Giacomo i saj, filozofinë. Në Parma janë të pranishëm në një koncert, dhe Casanova shkruan: “Çfarë surprize! Henriette-a ngrihet dhe duke i bërë lëvdata djaloshtit që kish luajtur *a solo*, i merr violonçelin dhe, me një pamje modeste dhe të qetë, i thotë se do t’ia rriste edhe më tepër shkëlqimin. Sa s’fluturova kur e dëgjova të luante *a solo* dhe pastaj duartrokitjet që e bënë pothuaj të shurdhët orkestrën!”

Porse lumturia e tyre ndërpritet dhunasi në Versoix të Gjenevës në janar të 1750. Një njeri i familjes së saj e njehe, dhe ajo është e detyruar të kthehet në Francë. Ndarja është e dhembshme. Casanova e ka zemrën copë. Ajo hipën në një karrocë që largohet nëpër dëborë, dhe kur kthehet në dhomën e bujtinës *Des Balances* ku kanë jetuar të dy, ku janë dashuruar si askund, ai gjen fjalët e fundit që ajo i ka lënë të shkruara...

*

U nisëm menjëherë për në Versoix, që ndodhej rreth dhjetë kilometra larg Gjenevës, në breg të liqenit Leman. Diku kisha lexuar, a dikush më pat thënë se bujtina *Des Balances* ekzistonte ende në ditët e sotme. Kërkova në Google dhe aty

ishte. Që prej shekujsh. Një hotel i vogël familjar, tradicional, në qendër të Versoix-së, në adresën 18 Rue de Boucherie. E gjetëm lehtësisht; ishte një ngrehinë alpine trikatëshe me çati të pjerët të errët, me një fasadë të gjerë në gri të çelur, me dritare të mëdha e të thella të kornizuara me të bardhë dhe kanata prej druri në një gri më të zënë. U futëm në derën e ngushtë të hotelit, e cila ishte e hapur dhe porsa hymë brenda, pamë që në të majtë ishte një dhomëz me një tryezë, e cila duhet të shërbente si pritja e hotelit, por që nuk kishte njeri. Kështu që morëm menjëherë shkallët që ndodheshin pranë derës së hyrjes, pasi thirrëm që të na dilte dikush për të na pritur. Askush nuk u përgjigj. Ngjitëm shkallët e ngushta prej druri dhe në sheshpushimin e katit të dytë pamë një sobë druri antike dhe disa objekte të tjera të shumëvjetra që duhet t’i përkisnin historisë së bujtinës. Frymë njeriu. Vazhduam dhe u ngjitëm në katin e sipërm. Në çastin që rekesha të orientohesha për të gjetur dhomën që Casanova përmend te Kujtimet, u dëgjua një rrapëllimë çapash që ngjiteshin shpejtasi nëpër shkallë dhe një grua e gjatë, e hajthme, me flokë të thinjura të ngritura topuz, si një dhaskalicë angleze e shekullit XIX, u shfaq në krye të shkallëve dhe na pyeti rrëmbimthi: “Kush jeni dhe çfarë kërkonit?” Ishte e zonja e hotelit. “Dhomën e Casanova-s dhe të Henriette-s” thashë unë e zënë gafil, ndërsa vështrimi i ngulët i syve të saj të vegjël ngjyrë hiri më dogji që prapa syve me xham të trashë. Kisha folur pa e menduar gjatë atë që duhet t’i shpjegoja zonjës së hotelit, lehtësisht, njëlloj sikur t’i thosha “po kërkojmë dhomën ku fjeti Richard Gere-i javës që shkoi”. Kaluan disa çaste përpara se zonja e hotelit të përgjigjej sikur të ishte e përgatitur prej kohësh për atë pyetje që nuk e habiti aspak: “ky nuk është muze, është hotel...”. “E dimë” e ndërpreva unë dhe duke iu lutur shtova “Studioj biografinë e Casanova-s. A mundet vetëm t’i hedhim një sy dhomës?” “Kemi ardhur nga larg” shtova kur pashë një lloj mëdyshje te gruaja me pamje dhaskalice angleze të epokës viktoriane. Porse e zonja e hotelit kish marrë tjetër vendim. “Hoteli që kërkonit ndodhet në Gjenevë”, tha prerë. Uktheva dhe vështrova tim bir, i cili nuk kish folur gjer atij çasti. “Do rrimë këtu sonte” na u drejtua ai të dyjave. “Na duhet një dhomë me dy shtretër zonjë”, iu drejtua asaj më pas. Nuk pata kohë të thosha një fjalë, sepse zonja e hotelit na shoqëroi përnjeherë në katin e dytë dhe na dha çelësin e dhomës. Me ta marrë çelësin zbritëm dhe dolëm jashtë hotelit. Ishte ora shtatë e mbrëmjes dhe duhet të gjenim ndonjë restorant për të darkuar. “Si do t’ia bëjmë”, pyeta tim bir. “Nuk do kthehemi sonte në Bernë? Do ta kalojmë natën këtu? “ A nuk e pe si na shmangu zonja? Nuk të duket se po fsheh diçka?” m’u përgjigj. “Sigurisht. Nuk dëshëron që ta kthejë hotelin në pelegrinazh të adhuruesve të Casanova-s” thashë. “ E çdo të fitonte? E keqja është se nuk kemi pizhama për të fjetur apo ndonjë rrobë për t’u ndërruar, as furçë dhëmbësh.” “Verifikojmë ç’të mundemi më vonë dhe nisemi kurdoqoftë për në Bernë”, e mbylli bisedën im bir. U ulëm në një kafene- restorant aty pranë dhe darkuam ngadalë. Rreth orës nëntë u kthyem në hotel. Prej së largu vështrova me kujdes fasadën e tij dhe vura re se në katin e tretë siç e llogarisnim ne shqiptarët, apo në të





dytin sipas vendasve, dritarja në fund fare djathtas ishte e vetmja që i kishte kanatat e drunjta të mbyllura. “Ajo duhet të jetë dhoma, Marin”i pëshpërita tim biri. Dritat në dhomën e pritjes së hotelit ku qëndronte dhaskalica angleze e kohës viktoriane vazhdonin të hapura edhe pasmesnate kur u shtriva të qetësohesha e veshur përmbi shtrat, ndërsa im bir shihte një film bardhë e zi në televizor. E lodhur nga pritja që m’i kish tendosur nervat humba në gjumë. Kur u zgjova befaz, e trembur nga ikja e kohës, pashë se kisha fjetur disa orë të mira dhe se agimi nuk do vononte të vinte. Brenda panikut që më kaploi, u kujtova se gjatë bisedës së shkurtër me zonjën e hotelit kisha pikasur në jakën e këmishës së saj prej tyli që mbulohej nga një shall i madh e i trashë, një kapëse- medaljon prej fildishti në formë ovale, qarkuar nga një rreth i hollë i artë, i cili mbante brenda një portret në profil të gdhendur. Po si nuk më ishte kujtuar më parë. “Bëj be Marin se e kam parë me dhjetëra herë atë portret! Është Casanova” shpejtova t’i tregoja me një frymë. Im bir më tërhoqi pas vetes duke më pëshpëritur “nuk kemi shumë kohë” dhe dolëm në korridorin e heshtur. U ngjitëm në majë të gishtrinjve në katin sipër, dhe po në majë të gishtrinjve iu avitëm derës së dhomës së fundit djathtas që përkonte me dritaren me kanata të mbyllura. Kishim vendosur t’u shkonim gjërave gjer në fund për të mësuar të vërtetën. Me vete kishim një kaçavidë majëhollë që e kishim marrë nga makina. Dera e dhomës që kërkonim nuk kishte dorezë si të gjitha dhomat e tjera. Habia jonë ishte e madhe kur, ndërsa përgatiteshim të hapnim bravën e derës, padashur krahu im e shtyu dhe ajo u hap. Nuk ishte e mbyllur. Drita e korridorit na zbuloi për një çast brendësinë e saj. U ndalëm të mëdyshur në pragderë, por shpejt pamë se ishte bosh. Një dhomë krejt e thjeshtë, me një shtrat të madh, me disa orendi të pakta për qark; por sa hymë brenda, në terr, ndjeme një ajër ndryshe, një aromë të tjetërllajtë, të cilën më vonë arrita ta identifikoj si kujtimin e largët të aromës së pomadës me jasemin. Ndjemë

peshën e një kohe tjetër. Shpejtova të hapja kanatat e dritares së madhe që dukej si e ngallmuar. Nuk ishte punë e lehtë. Im bir erdhi dhe me ndihmoi. Hapëm me vështirësi kanatat e brendshme që dukeshin sikur kishin një jetë të tërë të mbyllura. Xhami që ngrihej sipër ishte i dyfishtë dhe i mbuluar nga një kortinkë prej tyli të lashtë që jepte përshtypjen se ishte ngjitur pas tij. Kanatat e jashtëme u hapën me një gërvimë çjerrëse dhe drita e përqu mëshë agimit vërshoi në dhomë. Vura re se mobiljet e thjeshta të dhomës ishin të ngjyrosura dhe të lyera me llak sipas teknikës së shekullit XVIII arte povera. Në anën e majtë të shtratit, përmbi një komodinë të zbukuruar me motive florale në një ton të blertë pastel ndodhej e pluhurosur një vepër e Ariostos. Poshtë saj, në shpinë të një libri tjetër dallohej emri i Petrarkës. Ndërkaq im bir po mundohej të hiqte kortinkën e tytit nga xhami i ulur; ajo pothuaj iu thërmua në duar. Drita e agimit ishte bërë më e fortë dhe e kulluar. Iu avita xhamit të çliruar nga kortinka prej tyli; fjalët e gdhendura mbi xham përpara pothuaj dyqind e shtatëdhjetë vjetësh me diamantin e unazës dolën të plota dhe të qarta përpara syve të mi: “Ke për ta harruar edhe Henriette-n.” Jashtë dritares kishin nisur të binin fjolla dëbore të pastër. Hodha vështrimin përtej dhe pashë udhën që çante përmes pyllit për në Versonnex të Francës. Me sytë e kujtimin pashë karrocën që po e shpëste Henriette-n nga krahët e Casanova-s tek largohej me shekuj nëpër të.

Zbritëm poshtë. Në majë të gishtrinjve, ndonëse ishim të bindur se hoteli ishte krejt bosh. Na priste zonja e hotelit. Na serviri kafe. Pasi paguam, i zgjata dorën me mirënjohje për t’u përshëndetur. “Emri i saj ishte *Henriette Jeanne-Marie Boyer Fonscolombe*” më tha ngadalë në formën e lamtumirës, dhe unë u përqëndrova te kapsja-medaljon në jakën e këmishës së saj prej tyli. *Isha shumë afër. Me habi zbulova se portreti i gdhendur në fildisht brenda rrethit të artë nuk ishte ai i Casanova-s, por profili i bukurisë së pasqorë të Henriette-s.*

NUK DUHET VETËM NJË DITË

(Refleksion me rastin e 20 majit, Ditës Kombëtare të Jetimëve)

Nga ZHULIANA G. JORGANXHI

20 Maj është Dita Kombëtare e Jetimëve... Dita e Dashurisë Njerëzore, kushtuar krijesave më të bukura dhe më të pafajshmëve të kësaj bote. Është dita e miturakëve pa krahë, e fëmijëve pa fëmijëri, e atyre që kanë humbur familjen, çerdhen e ngrohtë të kujdesit prindëror. Kjo ditë, i thërret ndërgjegjes së çdo njeriu të mendojë qoftë edhe për një çast të vetëm për të ndezur një dritë shpresë, e paskëtaj, të zgjojë kaq shumë ëndrra të plagosura që në embrion, që, gjithsesi, ato mbeten gjallë tek këto krijesa engjëjlore nëse dikush kujtohet për ta. Si intelektuale, si Grua dhe si Nënë, gjykoj se nuk do të mjaftonte vetëm kjo ditë për të menduar dhe për të reflektuar për këta fëmijë shpesh herë të pafat. “Fëmija pa nënë, si nata pa hënë!”, na thoshnin dikur plot dashuri e dhembshuri gjyshërit dhe gjyshet flokëbardha, nënat dhe etërit tanë të mirë... Mjafton kjo thënie, e cila na kujton të gjithëve ato të përpjekje të mëdha njerëzore për mbijetesë ardhur nga brezat, që të mendosh sa e vështirë është jeta e një jetimi, pa votrën ku mëkohet dhe ngjizet në çdo çast dashuria dhe ngrohtësia prindërore. Vetëm një shoqëri e shëndoshë dhe e drejtë, që kthen sytë nga këta fëmijë dhe tek ata në vështirësi ekonomike e cila mendon edhe për të ardhmen e tyre, mund të jetë një shoqëri e denjë njerëzore. Në fëmijërinë time kam njohur fëmijë jetimë, shumë prej tyre i kam pasur shokë dhe shoqe klase në shkollën fillore dhe atë shtatëvjeçare. Më vonë, i kam takuar në rrugët e jetës dhe jam gëzuar kur ata janë bërë njerëz të të aftë e të suksesshëm, që i kanë dhënë shoqërisë sonë, vendit të tyre. Jemi ulur në një bangë klase me ta, dhe për asnjë çast të vetëm, as unë dhe as bashkëmoshatarët e mij nuk kemi pasur ndonjë paragjykim, as edhe ndonjë ndjenjë mëshire. Jo! Ata ishin të barabartë në sytë e ne fëmijëve të tjerë, edhe në sytë e mësueseve dhe mësuesve tanë. Ndoshta, shumica e tyre vinin nga rrethe të ndryshme të Shqipërisë, kishte mes tyre jetimë nga nëna dhe ati, kishte nga ata, që kishin mbetur jetim vetëm nga njëri prej prindërve, kishte edhe nga ata, që për arsye ekonomike kishin gjetur strehë në Shtëpinë e Fëmijës, aty në qytetin tim të Korçës. Drejtori i kësaj Shtëpie Fëmije quhej Niko Çeçi, të cilin e shihja shpesh të aktivizohej me fëmijët jetimë në grupet artistike të Pallatit të Kulturës, si korist. Kjo tregonte, se ishte jo vetëm një organizator i mirë i kësaj Shtëpie të madhe për jetimët dhe për fëmijët me nevoja ekonomike, por ishte dhe njeri i dashuruar pas artit dhe kulturës. Në pamje të parë dukej i rreptë në zbatimin e rregullave, por fëmijët e respektonin dhe e donin, sepse tek ai shihnin figurën e një ati. Kam parë, kur erdha në Tiranë në rrugën e Elbasanit, ku ngrihej dhe konvikti i ne vajzave studente, Shtëpinë e Fëmijës. Më dhembte kur i shihja të gjithë të veshur njësoj, por kur në atë shtëpi erdhi si drejtoreshë e ndjera Evanthe Ciko, ndryshoi veshja e atyre fëmijëve... Zonja e ndritur Evanthe, ishte jo vetëm një nënë model e fëmijëve të saj Zhanit dhe Ketit, por edhe një mësimdhënëse dhe edukatore për vite të tëra në shkollat e kryeqytetit. Ajo ishte dhe një grua fisnike dhe e përkushtuar, që tek fëmijët jetim në Shtëpinë e Fëmijës ku ajo drejtonte këtë institucion, shihte fëmijët e saj. Ndaj la tek ata përjetë gjurmët e respektit dhe nderim për punën e madhe që bëri ndër vite. Kur je fëmijë, gënjejsh dhe më një lodër, por kur fëmija fillon dhe ndërgjegjësohet, atëherë duhet një kujdes i veçantë për të. Dikush mund të ketë të dhëna natyrore për pikturë, dikujt natyra mund t’i ketë dhënë një zë të bukur, dikush e vuan më shumë se të tjerët mungesën e prindërve, sepse nga natyra është më i ndjeshëm, dikush më i shkathët. Mirëpo, çdokush pra, që merret me këta fëmijë duhet t’iu përkushtohet atyre me shpirt e zemër. Për këta fëmijë, në rradhë të parë duhet të kujdeset shteti, organizatat jo qeveritare dhe e gjithë shoqëria. Kjo nuk duhet bërë vetëm me një ditë, as në formë “fushatë”, që i ngjan më shumë asaj të një parade, se ja, edhe ne mendojmë dhe punojmë për këta fëmijë, që jeta i’u dha një fat jo të lehtë. Kjo do të ishte sa fyese për këta fëmijë, nga ana tjetër edhe një shfaqje mëshire. Mëshira, që mund të shfaqin njerëzit ndaj tyre i fyen rëndë ata, ua cënon dinjitetin dhe krenarinë. Këta fëmijë kanë personalitetin e tyre, si çdo fëmijë i zakonshëm, që rritet në kushte normale pranë familjes së tij. Ndaj lypset që çdo zyrtar me një pozicion në qeveri, në Parlament (*se përse na duhen parlamentarët, kur nuk çojnë në atë tribunë hallet e një populli?!*), duhet të mendojë dhe të veprojë për më të mirën e fëmijëve jetimë dhe atyre që ndodhen në vështirësi ekonomike. Nevojiten politika dhe programe efektive të ndihmës dhe të mbrojtjes sociale për të gjitha ato familje dhe fëmijë që jetojnë në një varfëri të skajshme. Këta fëmijë, qoftë ai jetim ose i rritur në vështirësi, rriten para kohe kur përballen me vështirësi dhe mungesa të përditshme bazike. Mund t’i gëzojë një çast një dhuratë bamirësie dhe nuk e harrojnë këtë gjest, por jeta është e gjatë. Çdo ditë dhe çdo orë, ata fëmijë kanë nevojë jo vetëm për një fjalë të mirë, për një buzëqeshje e ledhatim, por së pari për një jetë normale si gjithë fëmijët e tjerë. Vitet ikin dhe qoftë jetimët, qoftë ata të asaj pjese të shoqërie që vuan nga varfëria, rriten një ditë, se jeta ka ligjet e saj. Por, ç’bëhet me ata adoleshentë, të këtyre kategorive në Shqipërinë tonë? Fëmija i rritur në një Shtëpi Fëmije vjen një ditë dhe duhet ta lërë atë strehë. Adoloshenca është moshë më delikate e njeriut...! Gjithmonë më ka shkuar mendja tek ato vajza, që një ditë, duhet të lenë në moshën më delikate Shtëpinë e Fëmijës, dhe, të mbetura mes katër rrugëve, pa asnjë përkrahje shpesh bien në grackën e njerëzve të paskrupull e kriminelë të pashpirtë, që shfrytëzojnë mjerimin e tyre dhe i çojnë në rrugë pa krye, deri në prostitucion. Dikur, bashkëmoshatarët e mia jetimbetura, arrinin të mbaronin shkollën e mesme të përgjithshme ose profesionale dhe gëzoheshin kur i takoja, sepse bëheshin të zonja të jetës së tyre dhe që kishin formuar familjet e tyre. Sot, ka një Institut Kombëtar i Integritit të Jetimëve Shqiptarë, të cilin e drejton me pasion dhe përkushtim të madh, miku im i vyer Ilir Çumani, një tjetër ish fëmijë jetim, pasioni, përkushtimi dhe puna shembullore e të cilit në gjithë këto vite, ka bërë që shumë jetimë të kenë shanse duke mundur të krijojnë jetën e tyre ndershmërisht. Ideja dhe nisma që ndërmori afro dy dekada më parë Instituti Kombëtar i Integritit të Jetimëve Shqiptarë që, 20 Maji, të fiksohet në kalendarin e çdo viti si “Dita Kombëtare e Jetimëve”, kishte si qëllim një mision sa fisnik, aq edhe human. Kjo nismë ka synuar në gjithë këto vite përpjekjen për të zgjuar ndërgjegjen e gjithsecilit prej nesh, për të vënë në lëvizje të gjitha mekanizmat e ndihmës dhe solidaritetit dhe për të humanizuar edhe më shumë shoqërinë tonë, për të vënë në lëvizje dhe pozita pune institucionet tona politikbërëse dhe ato të ligjitzbatues për të bërë më të mirën për fëmijët jetim. Kjo pandemi, që preku botën mbarë, na nxorri dhe ne në pasqyrën e së vërtetës, na tregoi sa të dobët jemi realisht, sa indiferentë dhe egoistë jemi të gjithë, me në krye pushtetarët dhe ata që bëjnë pjesë në atë Parlament, sepse nuk nevojiten vetëm fjalët dhe premtimet solemne më 20 Maj, në “Ditën Kombëtare të Jetimëve”. Një ditë, është shumë pak, sado të bëhet për jetimët dhe fëmijët që rriten në varfëri...!

Trieste, Itali

THJESHTËSI NË QËNDRUESHMËRI

mbi librin "Kapitulli i Amerikës" të Fatos Kongolit
nga Josif Papagjoni

Sa mbarova librin e fundit të Fatos Kongolit “Kapitulli i Amerikës”, me nënshkrimin e tij të datës 27 prill 2020, kohë pandemie. E lexova brenda ditës. Nuk mund të them se qe një biografi, sado e kufizuar në kohë, që më la pa mend. Ka jetë shumë më interesante në botë se kjo e Fatosit, merret me mend. Por nuk ka aty gjësende që klithin, nuk ka “thagma” të padëguara, nuk ka aventura e mendjeshkrepje që të lënë me gojën hapur. Jo! Është tjetërfarë. Por do ta them pakëz më poshtë arsyen përse...


...Në gjysmën e parë të viteve '70 Fatos Kongoli ishte redaktor në gazetën “Drita” dhe mbulonte dy faqet e saj “Teatër-Kinematografi”. Unë shkruaja asoherë si kritik i ri në këto arte dhe jo rrallë ngjitja shkallët e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, kati i dytë, aty ku qe redaksia e gazetës. Në tavolinën përballë derës së hyrjes qe Fatosi. Kisha shkruar një artikull problemor dhe po interesohesha për fatin e botimit. Ndofta qe i pari që kalonte nga duart e tij si redaktor te ajo gazetë. Ai hapi letrat e daktilografuara dhe mbi to vura re disa shënime shkruar me laps, vija që kryqëzoheshin dhe diku anash ndonjë shtesë me shkrimin e tij si të shtrembër. “Zakonçilla”, më tha me një fjalë rusishte që s’e prisja, domethënë “mbaroi”, do botohet. Unë e dija rusishten dhe m’u ngroh trupi nga përgjigja pozitive e tij. Ngriti fytyrën e skuqur ku përimitoheshin rrjeta kapilarësh nën lëkurë. Kishte një buzëqeshje që sikur ia vinin në spikamë dy hullitë në ndërmjemen hundë-buzë, mollëzat me një të kuqe si të trandafiltë dhe sytë me dritë. E gjitha ishte tejet pranuese, madje si prej njeriu lojçak. Më pas ne bashkëpunuam në shumë shkrime dhe ai ishte habitshëm shumë besimplotë dhe dashamirës ndaj tyre (apo ndaj meje!). Kjo ushqe tek unë një ndjenjë “ndryshe” në raport me redaktorët shpesh të zymtë dhe “kompetentë”, që mezi të flisnin. Ky njeri ishte pranues, aspak pedant; nuk sorrollejte nëpër vërejtje, sugjerime, shih këtë fjalë këtu, ndreq atë tjetrën atje, mendoj se, them se, shiko se dhe dër-vër... Kishte një cilësi që sikur buronte prej atij vetë: THJESHTËSINË.

Dhe këtë cilësi unë e kam vërejtur në gjithë romanet e Kongolit. Stili, thoshin grekët, domethënë krijimi, është vetë njeriu, pra shkrimtari. Kam shkruar disa shkrime për romanet e Kongolit. Në dukje ata s’janë “kushedi çfarë”, nuk të hutojnë me “kulturë”, “mite”, “metafora”, “paradokse”, “paradigma formale” etj., por hajde gjeje ti se pse kur i merr ato në dorë, romanet vrapojnë si lumenjtë pjerrinave, gati sikur të ikin duarsh, përthithesh aty, humbon dhe ja ku e mbyll faqen e fundit. Dhe thua: sa shpejt?! Po pse? Unë jam një farë kritiku i letërsisë dhe arteve dhe mund të sillja një dëng me argumente, fraza, parime, terma, s’e kam fare të vështirë. Por të gjitha s’vlejnë asnjë hiç nëse libri të mban ftohtë, nëse mendja tënde nuk rrëmbehet prej tij. Dhe them se një nga të fshehtat e librave të Fatos Kongolit janë jetët e “rëndomta” që ecin buzë tragjedive, krimi, zvetënimit, dëshpërimit, tjetërsimit, trysnisë; është stili që gur qosheje ka thjeshtësinë e rrëfimit, pa ndërlikime dhe fjalë të stërzgjedhura, që duken si me peshë e me një gravitet dërmues, por që janë bosh; nuk janë aq për mendjen, më saktë për stërhollimet e saj, sesa për zemrën. Romanet janë si kronika njerëzish që, edhe pse i paraqesin këta njerëz shpesh si qen të rrahur rrugësh, të shkalafitur, të trembur, të hutuar, të vetmuar e të ngjuar nëpër burgjet e tyre shpirtërore, befas nën zhguallin tjetërsues ti shquan ca shpirtra sa rebelë aq dhe të ndjeshëm, gati-gati ca kokëkrisur e të handakosur, që edhe pse në dëshpërim e bjerrakohje, ngjan sikur bëhen bash radioskopia e jote, e jona, e NJERIUT. Posaçërisht e njeriut nën diktaturë por edhe e atij pas saj. Radioskopi që dëshmojnë njolla të errëta e të forta në mushkëritë sociale të shqiptarëve, ku më shumë e ku më pak te të gjithë ne si personazhe të dy kohëve, para dhe pas vitit 1990, në çartjet, jermin, shajnitë dhe absurdin që na shoqëronte dikur dhe që vijon të na shoqërojë edhe pas shembjes së të keqes, ku qemë kredhur kokë e këmbë. Veçanërisht e mrekullueshme shfaqet kjo në romanet e tij “Lëkura e qenit”, “I humburi”, “Kufoma”, “Iluzione në sirtar”, “Bolero në vilën e pleqve”, “Si-do-re-la” etj.

Edhe këtë libër të dytë pas “Iluzione në sirtar”, që sjell jetën e shkrimtarit ecejakes së tij Shqipëri-Amerikë dhe që Kongoli e ka titulluar “Kapitulli i Amerikës” (s’më duket i qëlluar ky titull), ai bën personazh vetveten në disa çaste të thukëta. Unë, teksa i bëj një prerje librit të porsalexuar, lë pas dore shumë episode, ngjarje, marrëdhënie e personazhe që popullojnë faqet e tij, të cilat ngjallin interes se janë emra të njohur të botës së kulturës dhe artit; lë pas dore përshkrimet dhe qerthullin e familjes ku ai ecejaket; lë pas dore disa përshkrime të bukura marrëdhëniesh me të tjerët, ku bëzan vetiu karakteri dhe personaliteti i Fatosit si njeri, siç thashë, modest, që nuk do të duket, gati-gati si një “kapelan” që çapon i vetmuar kishës së vet; lë pas dore të gjitha mjeshtëritë dhe “hiletë” prej shkrimtari për t’jua ofruar mendjen e tij lexuesve të vet; por nuk mund të lë pas dore “Portën e Shën Pjetrit” ku ai trokiti. Nuk lë pas dore sidomos çastin kur Shën Pjetri i tha: “Prit dhe ca kohë, o njeri, ende s’të ka ardhur koha të vish tek unë!” Pra, nuk e lë dot pas dore përshkrimin mjaft emocional, gjithnjë përmes një narrative të thjeshtë, por tejet të besueshme, të përballjes së shkrimtarit me vdekjen, me sëmundjen, me operacionet e vështira që hoqi mbi trupin e lodhur. Me sfidën. Më ngritjen në këmbë. Me ringjalljen. “Jezusi” ishte brenda mendjes dhe vullnetit të tij teksa i tha: “Çohu Lazar!” Dhe Fatosi u çua. U çua saje vullnetit të tij, asaj dashurie që i rrethrotullohej brenda trurit për të shkruar romanin e munguar; romanin që shkrepse diku zgafelleve të materies gri, si një spërndritje. Atë magmë që herë kridhej në mugëtitirë a herë tjetër shfaqej në ag e rrekej t’u jepte dritë, ngjyrë e caqe gjësendeve ende të pashprehura, por që përthitheshin nëpër honet e pavetëdijes së shkrimtarit si fantomat. Mos ndofta RINGJALLJA e Fatos Kongolit ishte vetë letërsia?! Drita estetike?! Kurmi i saj gjithë aroma?! Mos vallë “Çohu Lazar!” qe e pathëna ende, meraku, mistika e krijimit, amaneti i shkrimtarit, britma e artit?! Ai vezullim që letërsia ka, ajo grishje, ai tingull i çuditshëm, i parrokshëm nga arsyeja dhe kthjelltësia e mendjes së ftohtë e sfiduese, vjen në faqet e këtij libri si një e fshehtë që herë pas here vezullon; është vetë procesi krijues që mban në vetvete, aty thellë, fillesat e veprave të reja?! Askush s’e di se si vezullon ideja e një vepre të re. Në çastin më të rëndë, që nga vdekja, ajo vjen si dritë shpëtimtare. Bash kështu i ka ngjarë Kongolit. Edhe Orfeu zbriti në Had për të rikthyer në jetë Euridiken e tij, i ra lirës me shtatë tela dhe Hadesi e lejoi të hynte aty ku asnjë i gjallë s’kishte hyrë më parë. Por medet, ai e ktheu kokën pas për të parë të dashurën nëse e ndiqte teksa do dilte prej andej. Dhe ajo mbeti në ferr. Fatosit lumnisht nuk i ndodhi kështu. “Euridiken” e tij, pra romanin “Gënjeshtarë të vegjël”, nuk e la në rrokapjekthin e Hadit, e mashtroi “Thanatosin” dhe nuk e ktheu kokën si Orfeu i tingujve magjepsës. Ai doli nga vdekja në jetë dhe romanin e botoi. Ishte vallë një amanet, një ankth, diç që ngujohet thellë qenies, dhe dalja prej burgut të ngujimit dhe përpëlitjes ishte, gjithëpo aq, edhe çlirimi i tij, metafora e Jezusit: “Lazar, çohu nga varri?!” Këtë as dreqi s’e shpjegon dot, paçka se mjekësia, operimet, kujdesi, fizioterapitë, mbështetja dhe përkushtimi i të shoqes gjatë lëngatës dhe gjithë kronika e shumë hollësive që e përbëjnë çastin e mbramë, po aq të tmerrshëm, ai e përshkruan, sikundër e thash disa herë tashmë, me një THJESHTËSI mallëngjyese. Ja, kjo është ajo që më tronditi te ky rrëfim jete i një njeriu të njohur, i një shkrimtari që e ka fituar admirimin dhe mirënjohjen e mijëra lexuesve, pa trompa e tam-tame, por ashtu, përunjësisht, thuajse si një “franceskan këmbëzbathur”, i thjeshtë, mes të thjeshtëve, njerëzor mes njerëzurve...

Afërmendsh që si një libër autobiografik, më së shumti në kufijtë e 7 vjetëve kur Fatos Kongoli jetoi, shkoi dhe erdhi Amerikë-Shqipëri, ai ka sjellë shumë njohje, episode dhe marrëdhënie me njerëz të ndryshëm të botës shqiptare në Amerikë, por edhe





në Shqipëri, njerëz që të mbresojnë me përshkrimet si Betim Muço apo Roland Gjoza, Piro Mani apo Inva Mulo, por edhe njerëz që ekranet televizive dhe fama nuk i prekin. Por ata, veçse, janë aty, të pabëzajtë. Janë si një sfond thuajse liriko-poetik, që shpesh i tejkalojnë “të famshmit”, sepse kanë diçka shumë më të thellë, shumë më të prajtë, shumë më fisnike: zemërmirësinë. Është një asht i fortë rrëfimor i këtij libri. Nuk do doja të veçoja njerëz dhe episode të ndryshme që i sheh në faqet e tij, qoftë dhe një Kadare a një Rexhep Qosja, por e kam të domosdoshme ta them se edhe për më të thjeshtin e të rëndomtin njeri, Kongoli nuk rri dot pa falenderuar. Ndofta kështu mund të bëjë gjithkush nga ne kur ka mbërritur në Portat e Shën Pjetrit një grimëherë dhe është rikthyer. Sepse ato “porta” të bëjnë të mirë; të bëjnë të kuptosh sesa e shkurtër është jeta dhe sa e pafund shpirtdëlirësia. Fatosi nuk ka nevojë për përshpirtje, por për përfalje. Ka nevojë për dorën e zgjatur. Ka nevojë për fjalën e mirë. Ndofta kjo është një nga arsyt përse libri ka në vetvete shumë mirënjohje për të tjerët. Është një libër dashurie. Një deklaratë dashurie. Për jetën. Për njerëzit. Për këtë Shqipëri që e duam dhe e pështymë. Jo më kot grekët e hershëm e më pas rilindësit e Evropës e çmonin njeriun si veprën më të lartë dhe poemën më të madhe të Natyrës dhe Demiurgut. Dhe ne kujtohemi për këtë, kur ndjejmë se udhëtimi ynë po mbërrin te “Porta e Shën Pjetrit”. E thashë për të vënë në spikamë atë “dritë qiriu” mirësie dhe butësie që ti mund ta shohësh gjithkund faqeve të librit, por e thashë edhe për të bërë një përjasje midis dy librave të Kongolit, të ngjashëm për nga tipologjia, “Iluzione në sirtar” dhe “Kapitulli i Amerikës”. Nëse të parin do ta quaja një ecejake mes prapësive, të keqes, torturës shpirtërore, shpifjeve prej njerëzish të ligj, të dytin do ta quaja një ecejake mes mbarësive, të mirës, paqes shpirtërore, blatimeve prej njerëzish të mirë. Dhe nga më të mirët njerëz që e rrethojnë Kongolin, përveç gruas, fëmijëve dhe familjarëve të tij të kudogjendshëm, përveç dhjetëra e qindra artistëve e shkrimtarëve shqiptarë e të huaj që e kanë dashur dhe vlerësuar, më i madhi syresh, miku më i madh i tij është LEXUESI. Edhe unë jam njëri syresh. Këtij miku ai i përfalet, i përkulet. Rrëfimi kur Fatosi flet për këndin e shkrimtarit të Shtëpia Botuese “Toena” gjatë panairëve të librit dhe lexuesit që i afrohen atij, nënshkrimeve që ai hedh mbi romane, harresave plot humor të emrave, e gjitha është vërtet diçka e këndshme, por që, megjithatë, përtej humorit, zbulon katërcipërisht atë çka e thashë në krye të këtyre fjalëve: THJESHTËSINË e tij.

T’u-ngjat-jeta Fatos Kongoli!...

NË RRUGËN E NJË TRADITE TË RE LETRARE

nga Adnan Mehmeti

President i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë

Në dhjetor të vitit 2001, një grup i vogël shkrimtarësh, u mbledhën me një mision të madh e të dobishëm: të krijonin të parën Shoqatë shkrimtarësh në Amerikë, që ishte bërë prej vitesh vendi i tyre mikpritës. E pra, nismëtarët e asaj dite duhen kujtuar me nderim. Po më shumë se të tjerët kurorën e nderimit do ta meritonte themeluesi dhe presidenti i parë i Shoqatës, Gjekë Marinaj. Ai ishte në kontakte me një numër të vogël krijuesësh, që e përkrahën dhe i dhanë shtytje formimit të saj.

Lajmi mori dhenë. E që nga ajo ditë Shoqata u rrit në numër e në cilësinë e krijimeve. Sado optimist që të ishe, mbase sot nuk do ta besoj se sa shpejt u rrit në pak vite, u forcua, bëri sa e sa aktivitete dhe ja sot ne paraqesim një libër me të gjithë anëtarët e kësaj Shoqate që e kanë lidhur jetën e tyre me Amerikën, me të gjithë ata që në vite, kanë misionin fisnik, përcjelljen e fjalës artistike.

Ky libër, në një farë mënyre, është dhe biografia me bibliografi të secilit anëtar, deri në ditët e sotme, pa pasur ndonjë synim për të dhënë ndonjë vlerësim kritik. Secili prej tyre përfaqësohet me një krijim letrar. Radhitjen e tyre e kemi bërë duke ndjekur kriterin alfabetik.

Gjatë këtyre viteve ka pasur nga ata që nuk angazhohen apo nga ata që për arsye të shumta janë larguar. Ne i kemi përfshirë, sepse i vlerësojmë dhe do t’i vlerësojmë edhe më tutje, si pjesë e këtij historiku. Në këtë përpjekje për një panoramë të shkrimtarëve shqiptaro-amerikanë ka edhe një numër të vogël shkrimtarësh që nuk janë përfshirë, sepse nuk i takojnë grupimit tonë, por dhe ata janë të vlerësuar dhe të mirëpritur në të ardhmen.

Duke i lexuar dhe rilexuar krijimet e këtyre krijuesve të moshave të ndryshme, qoftë ata që jetojnë apo dhe ata që janë të ndarë nga jeta, të emocionon dashuria, me të cilën janë grumbulluar këto krijime. E lexon me vëmendje dhe sheh një etje për shkronjëshqipen këtu në Amerikën e largët, ku ata kanë marrë rrugëtime të reja për një të nesërme që i bën nder të dy kombeve.

Jam me fat që secilin anëtar e njoh personalisht. Jemi takuar, takohemi dhe bashkëpunojmë: me dikë më pak e me dikë më shumë, por të gjithë së bashku jemi pjesë e një emri të përveçëm: “Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë”.

Përtej kësaj tradite njerëzore, këtë mision e merr edhe kjo panoramë që do të ketë këtej e tutje një galeri të tërë emrash të nderuar. Mirënjohje edhe për brezin e shkrimtarëve shqiptarë të shekullit të kaluar.

Le të gdhendim me këtë libër e me të tjerë që vijnë më pas, faqe të reja të të shkruarit shqip këtej Atlantikut. Mendoj se kështu afrohen, ndihmohen dhe bashkohen edhe më shumë shkrimtarët. Duke u njohur sa më shumë, dhe duke njohur krijimtarinë e njëri-tjetrit, ne njohim më mirë letërsinë shqipe që po krijohet në Amerikë.

Duke shfletuar librin, formohet bindja se udhëton drejt viseve të bukura të Shqipërisë mëmë e të trojeve amtare. Aty gjen anëtarë nga të gjitha krahinat: nga Shkodra, Elbasani e Gjakova, Saranda, Tropoja e Prishtina, Vlora, Mati e Klina, Peja, Lezha e Struga, Presheva, Bujanoci e Korça, Përmeti, Tepelena e Kërçova, Gjirokastra, Prizreni e Tirana, Fieri e Malësia e Madhe, Himara, Tepelena e Dibra, Plava e Çamëria.... por që kanë një atdhe të dytë Amerikën dhe këtë fole të përbashkët krijuesish.

Mbase na duhet edhe sot e kësaj dite të citojmë vargjet e të pavdekshmit, Fan S. Noli:

*“Mbahu, nëno, mos ki frikë
Se ke djemtë në Amerikë!”*


Mbase Noli nuk e kishte saktësisht këtë thirrje kaq të vyer për shkrimtarët që shkruanin e që do të shkruanin shqip në Amerikë, për pasardhësit e fjalës së bukur shqipe, për poetët, tregimtarët, romancierët, gazetarët, përkthyesit, po ky dyvargësh-lapidar i përmasave profetike, do të shkonte pak a shumë edhe kësaj përmbledhje.

Mjaft autorë shqiptaro-amerikanë të cilët janë anëtarë kanë nisur edhe botimin në gjuhën angleze të veprave të tyre. Këto e pasurojnë jo vetëm biografinë e tyre letrare, por bëhen edhe pjesë e kulturës ku ata jetojnë dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre letrar.

“Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë (Autorë dhe vepra)” del para lexuesve pas botimit të parë “Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë (Aktivitete dhe krijimtari)” botuar në vitin 2016. Në librin e parë kemi mbuluar të gjitha aktivitetet. Në këtë libër po paraqesim anëtarët e saj. Të dyja, bashkërisht, plotësojnë tërë rrugën që nga themelimi deri në vitet e fundit.

Modestisht, me përgjegjësi, dhe me shumë dashamirësi punova për të kompletuar historikun e lidhjes sonë. Secili anëtar ka një histori në vete dhe të veçantë. Kam gjurmuar gjatë për biografinë dhe njoh veprat e tyre të botuara, pjesë e bibliotekës së Shoqatës. Shumë prej tyre kanë kryer në vite edhe detyrën e gazetarit për organe të ndryshme të shtypit në trojet shqiptare apo edhe në Amerikë.

Qëllimi dhe dëshira ime po realizohet duke i sjellë para lexuesit. Siç stolisin qiellin yjet, ashtu edhe secili anëtar, dikush me më shumë libra e dikush me më pak libra, por që secili prej tyre ka shkëlqimin dhe rëndësinë e vet. Bashkërisht krijojmë dhe e mbajmë të gjallë Shoqatën e Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë.



DASHURI E VONUAR

proza poetike

Nasho Jorgaqi

DREJT FUNDIT TË RRUGËS

Po shuhen pak nga pak ëndjet. Më pak po ndiej e më shumë po kuptoj. Dëshirat po largohen pa u kuptuar. Syri nuk po e mban më dritën e diellit. Gjaku po fillon të vaket. Stinët po i ngjajnë njëra-tjetrës. Më dendur po më vijnë zëra të njohur e më rrallë zëra të rinj. Një nga një miqtë po më ikin. Askush nuk më ndihmon të mbrohem nga vetmia. Si mund të jetë ndryshe fundi?!

PAS TEJE

Në dashuri rashë pas hapit tënd, sa harrova hapin tim. Pas heshtjes sate u harrova, sa fjalët s'kishin kuptim. Pas takimeve me ty u hutova, sa bota përquar më ngjante shkretëtirë. Pas aromës sate u shastisa, sa s'dija të merrja frymë. Deri dhe hijen tënde dashurova, pa menduar se një ditë vetëm ajo do të më mbetej. Dhe m'u kujtuan vargjet e poetit: "Aq pranë teje pata qenë, sa mërdhij pranë të tjerave."

KUR...

Kur kridhem në mendime a kur i dorëzohem muzikës, kur magjepsem pas ndonjë peizazhi a kur rend në gjurmë të kujtimeve, kur më trallis një ëndërr a kur më sjell në vete një zhgjiëndërr, vetëm atëherë ndihem i tëri brenda vetes.

LUM DHE MJERË...

Gjithë e fshehta e ekzistencës është të mbahesh pas shpresës. Ajo mund të jetë brenda dhe jashtë teje. Mund të jetë mbi tokë, mund të jetë nën qiell. Po prapë mbetet po ajo. Pjesë e jetës e pandarë. E pandarë nga shpirti, e pandarë nga zemra. Lum ai që mbahet pas saj e mjerë ai që s'mbahet dot.

MEDET

Medet si u rrëzuan ashtu urat mes tyre. Ato ura që i bënin të hynin e të dilnin lirisht te njëri-tjetri.

Po tani që urat ranë, ata vetëm në horoskope mësojnë se ç'bëhet në shpirtrat e shoshoqit. Mbeten pyetje pa përgjigje.

LIRIA

Vetëm këtu lart, në majë të këtij mali të thepisur, ku lëvizin e përqafohen retë, ku mistershëm pëshpërisin erërat dhe horizontet farfurijnë në të katër anët, shpirti i njeriut ndihet krejt i lirë dhe i vjen të fluturojë.

HESHTJA

Në çaste meditime të thellë mundohem të komunikoj me heshtjen. Të komunikoj me gjuhën e saj. Në gjuhën e përjetshme të gjithësisë. Sa herë e kërkoj, sikur më vjen pranë. Përherë e padukshme, e patrajtë. Duket se zbret nga vendet përquar, gjendemi përballë njëri-tjetrit. Si dy të njohur, si dy të panjohur. Në pritje për të komunikuar, në pritje për të kuptuar gjuhën e saj, gjuhën më të lashtë të botës.

ÇASTI I LUMTUR

Ja që arrita ta kap çastin e lumtur. Çastin që zgjat sa regëtima e dritës së xixëllonjës dhe i bën njerëzit e dashuruar të mrekullohen. E kapa dhe e rroka fort në gji. Dridhesha nga ngazëllimi dhe frika se mos më shpëtonte. As e shikoja, as e dëgjoja. Vetëm e ndieja me një marramendje gëzimi dhe ndrojtjeje.

Ai çast qëndronte brenda meje, ndërsa përpiqesha ta mbaja pas vetes. Dhe ndodhi ajo që s'e prisja: papritur erdhi e ngriu. Nuk arrija të kuptoja se ç'po ndodhte kështu me mua.

Vetëm tani, pas shumë vitesh, ndiej se ai çast i lumtur më qëndron në një krah të zemrës.

PERËNDIA IME

Dua të të dorëzohem ty, Perëndia ime. Të të hapem me gjithçka kam brenda vetes. Të më vështrosh tej e tej si një qenie të qelqtë. Të ma soditësh shpirtin në çdo kohë dhe t'u hapësh shtegun engjëjve për tek unë. Dhe të m'i dëbosh djajtë që flenë

brenda meje. Dhe të ma mbushësh veten me dritën e mirësisë. Vetëm atëherë mund të them se jam i denjë për ty.

PSHERËTITA

O këngëtar i maleve dhe i fushave, ti që nuk e di se ç'je në të vërtetë, bujk apo bari. Dua të të pyes se si të dolën ato fjalë dhe i fute në këngë, kur këndove: "Psherëtita dhe doli flakë"? Çfarë zjarri digjej brenda teje? Çfarë dashurie ishte ajo, që të digjte ashtu dhe të bënte të nxirrje flakë nga goja?

PËRQAFIMI

Isha fëmijë e u bëra burrë dhe nga pamja e oborrit të shtëpisë sime vetëm një gjë nuk ka ndryshuar: ulliri dhe pjergulla vazhdojnë të rrinë të përquar. Koha asnjëherë nuk i ka ndarë. Ngahera kështu i mbaj mend: ai i lartë, i thinjur, hijerëndë, kurse ajo e lakuar, e brishtë, e gjelbër dhe plot nur.

Ngahera të pandarë, ditën dhe natën, në të ftohtë e në të nxehtë. Ngahera të rrokur me njëri-tjetrin, në erë e në shi, në dimër e në verë. Ngahera të përquar nga rrënjët deri te kreshta e trungut. Vallë si nuk u lodhën, si nuk u mërzitën një herë?! Ç'është ajo forcë që vitet kalojnë dhe ata i mban në këmbë?! Ç'është ajo dashuri drurësh, që më zgjon aq ëmbël imazhin e përquafimit njerëzor?!

LOTËT E DRERIT

Ai u kthye nga gjahu me një dre, që e kishte vrarë në pyll. Para portës së shtëpisë e priste një i panjohur. Gjahtari u zmbrops disi. Diçka e lëndoi përbrenda. I huaji e përshëndeti në heshtje.

Gjahtari lëshoi gjahun në tokë dhe liroi rripin e armës, që e mbante në krah. Tjetri u ul në gjunjë dhe zuri ta vështronte me vëmendje kafshën pa jetë. Koka e drerit dukej si e gjallë.

- Sa keq! - psherëtiu i huaji.

- E pse? - ia priti gjahtari me ton të prerë.

- Shikoja sytë, - vazhdoi tjetri duke ia marrë drerit kokën ndër duar.

Gjahtari i hutuar bëri sikur i vështroi.

- Nuk ia shikon lotët që i kanë ngrirë në sy?

- Po, - u përgjigj i menduar gjahtari dhe pastaj, duke ngritur zërin, shtoi: - Kur e qëllova, nuk ia pashë, se, po t'ia shihja, nuk do ta vrisja.

- Sigurisht, se lotët nuk shihen nga larg, por nga afër dallohen, ama, - arsyetoi tjetri.

- Mund edhe të dallohen, - mërmëriti gjahtari dhe u duk sikur u rrudh në fytyrë.

- Kështu dhe ne njerëzit, - vijoi tjetri duke u ngritur në këmbë, - sepse, po të qëndrojmë afër dhe të shohim njëri-tjetrin në sy, s'do të na bënte zemra të qëllonim, apo jo?

Gjahtari nuk u përgjigj. Atë çast midis tyre sikur kaloi një vetëtimë. Ai njohu nipin e hasmit të fisit të tij...

PËRJETËSIA

Kam arritur në majë të kodrës. Poshtë farfuron pylli i argjenditë i ullinjve. Para syve të mi përjetësia shfaq fytyrën e saj madhështore.

EKUINOKSI

O mik i dashur, atë çka bën natyra me universin, e bën edhe me jetën e njeriut. Ndodh ekuinoksi i parë dhe dita fillon e i merr natën dhe horizonti i qenies sonë vezullon nga rrezet e dritës. Ndodh ekuinoksi i dytë, dita fillon e i jep natën dhe horizonti i qenies sonë regëtin nga hijet e para të errësirës.

Kështu përjetësisht përsëritet paradoksi: njeriu vjen nga drita dhe shkon drejt errësirës.

NGUJIMI I DRURËVE

Në këtë botë lëvizin njerëzit, kafshët, shpendët. Vetëm drurët nuk lëvizin. Hedhin rrënjë në një vend dhe qëndrojnë aty. Qëndrojnë të ngjuar fillikat ose disa bashkë, buzë rruge ose në kopshte, në pyje ose në fusha, në male ose në kodra. Shkojmë ne te drurët, ata kurrë nuk vijnë te ne. Na vështrojnë nga larg e nga afër dhe heshtin gjithnjë të menduar dhe enigmatikë. Vallë, përse natyra këto qenie të gjalla i ka ngjuar përjetësisht me trupin në qiell dhe rrënjët në tokë?!

ROBINSON

Kur anija m'u mbyt në detin e dashurisë, unë dola në ishullin e dhimbjes dhe mbeta tërë jetën Robinson.

KUR FITON DASHURIA

Vetëm si t'ia kemi thënë të gjitha njëri-tjetrit, atëherë ka fituar dashuria.

Vetëm si të arrijmë të durojmë njëri-tjetrin, atëherë ka fituar dashuria.

Vetëm si të mësohemi ta mbrojmë tjetrin nga vetja, atëherë ka fituar dashuria.

Vetëm si të mësohemi ta përmbajmë njëri-tjetrin, atëherë ka fituar dashuria.

Vetëm si të jemi mësuar përfundimisht me njëri-tjetrin, atëherë ka fituar dashuria.

PËRBALLË DHIMBJES

Përballë dhimbjes njeriu gjendet gjithnjë vetëm. Brenda tij hapet një humnerë dhe ai qëndron pezull në mes ndjenjës dhe mendimit. Kur përpiqet të mbahet pas

ndjenjës, ajo s'e mban dot dhe ai rrëzohet. Kur kapet pas mendimit, mbështetet te shtylla e vetes dhe qëndron.

PAS DERËS SË JETËS

Pas derës së jetës sime rri fëminia, rrinë lodrat, vrapi pas ylberit, dëshirat e shpërndara, padija e së ardhmes.

Pas derës së jetës sime rri rinia, rrinë ëndrrat dhe ngazëllimet, sulmi drejt qiellit.

Pas derës së jetës sime rri burrëria, fitoret dhe disfatat, pengjet dhe rendja për në luftën e jetës.

Pas derës së jetës sime rri pleqëria dhe mendimet, përdëllimi pas kujtimeve, nostalgia, trishtimi për çka lashë pas dhe padija se ç'më pret.

Në derë rri çelësi, që e hap dhe e mbyll koha.

KËSHTU JAM UNË

Monolog me veten e dialog me mikun. Flatra dëshirash, ishuj ëndrrash. Dritëza gëzimi, hije trishtimi. Heshtje që flet, heshtje që s'flet. Mall i largët, shtegtime mendimesh. Përjetime dashurie, kopshte kujtimesh. Thirrje nga brenda, vështrime nga jashtë. Libër i hapur, pre meditimesh. Trokitje në derë, karrige bosh. Pamje peizazhesh, variacione stinësh. Jehona prej së largu, pëshpëritje në vesh. Zëra të dashur, zëra të mërzhitur. Vegime të venitura, vegime të përndritura. Çaste që vijnë, çaste që ikin. Ngritje në qiell, zbritje në tokë. Kështu jam unë. Muzikë dhome.

HOROSKOPI

Yjet në qiell, ne këtu poshtë dhe fatin tonë e përcaktojnë ata. Luajnë yjet atje lart dhe nga loja e tyre varet gjendja jonë shpirtërore. Varet gëzimi apo trishtimi, ngritja ose rrëzimi, ora e mirë ose ora e ligë, të rrojmë apo të ikim. Vallë, ç'të jenë këto sinjale misterioze, që vijnë nga pafundësia e qiellit në botën tonë të vogël?!

HODHA NJË FJALË

Hodha një fjalë të butë dhe ndolla qetësi.

Hodha një fjalë të egër dhe ndolla stuhi.

Hodha një fjalë të stisur dhe zgjova kotësi.

Hodha një fjalë të hidhur dhe ngjalla mëri.

Hodha një fjalë zjarri dhe u dogja vetë.



DASHURI E VONUAR

Dashuri e vonuar është kjo dashuria ime. Jam unë që udhëtoj drejt teje dhe asnjëherë nuk të arrij. S'di je ti apo është mirazhi i ëndrrave të mia, që herë pas here më shfaqet në horizontin e jetës?!

DASHURIA E NDALUAR

Në këtë botë s'ka vend për ne të dy bashkë. Të ndarë po. Ti atje, unë këtu. Në mes, mali i mallit. Në këtë botë s'paska vend për ne të dy tok. Të ndarë po. Ti larg, unë afër. Në mes, lugina e trishtimit. Në këtë botë s'ka vend për të dy bashkë. Të ndarë po. Ti në një breg, unë në bregun tjetër. Në mes, lumi i dashurisë.

SHPIRTI

Kaloj fill vetëm nëpër këtë luginë të ngushtë të populluar me pemë, me drurë, me lule. Ngado që hedh sytë, këto qenie të natyrës më vështrojnë të heshtura. Diçka duan të thonë, po nuk arrijnë.

Unë sillem rreth tyre. Afrohem, largohem. Përpiqem t'i kundroj. Dalëngadalë pamja bëhet e lexueshme. Lexoj në sytë e petaleve, në ballin e trungjeve, në duart e zgjatura të degëve, në kreshtat e gjethnajave. Secila diç më thotë, secila diç më kumton. Është shpirti i hapur i natyrës, që i flet shpirtit tim.

ASKUSH

Askush veç teje nuk e di ku fle tek unë ai çast i lumtur. Je ti që vjen e zgjon dhe jeta ime ngazëlletet.

PA PËRGJIGJE

"Ah, sikur ta mbanim këtë ditë, që të mos ikte kurrë. Është dita jonë", - më the. "Po sikur të gjendeshim në Polin e Veriut, ku dielli s'do të perëndojë, çdo të bënim me ditën tonë të pafund?" - të pyeta. Ti i mbajte sytë gjatë tek unë dhe heshte, për të heshtur pastaj gjatë të dy.

DËSHIRË

Shoh diellin që perëndon, dëgjoj zhurmat mbi tokë dhe s'di si më lind një dëshirë krejt e veçantë. Dëshira që një ditë trupin tim të drobitur nga lufta e jetës së egër në hi ta kthenin. Dhe këtë hi rrënjëve të pemëve në tokën e kopshtit më të afërt ta hidhnin.

Dhe të ishin këto qershi apo kumbulla, mollë apo pjeshka, dhe hiri im të ushqente trungun e degët e tyre.

Dhe në pranverë të çelja me lulet dhe më pas të lidhja kokrra. Dhe kështu të përtërihesha nga moti në mot për të të kujtuar ty se unë isha gjallë si vetë natyra.

BUKURIA E ZHBËRË

O pasqyrë e brishtë e kujtimit tënd, ku dikur kisha mbledhur gjithë gëzimin e botës dhe drita jote mbushte qenien time, sa mizorisht u soll koha me ty!

Ç'bëri ajo ashtu? Si të veniti dalëngadalë, të hodhi hije nëpër vite dhe pastaj të plasariti e të theu? Të bëri copa-copa dhe ato copa i hapërdau andej-këndeje nëpër rrugën e gjatë të jetës sime. Mendoj këtë dhe trishtohem. Sa brenga ka, sa pengje. Dhe atëherë nuk di ç'të bëj. Kthej kokën pas dhe nis e kërkoj copëzat e pasqyrës së kujtimit tënd. Por më kot... Veç gënjej veten, kur përpiqem t'i mbledh, ashtu të shpërndara ditëve dhe netëve të trazuara. Po shpejt kuptoj se ajo pasqyrë magjiplotë e thyer pa mëshirë nga koha nuk ngjitet më. Se, edhe të ndodhte e pamundura që t'i mblidhja, prapë nuk do të arrija të sillja rishtas para vetes pasqyrën tënde, sytë e tu, nurin tënd. Sa i pafuqishëm qenkam!

ULLIRIT I NGJAJ

Ullirit i ngjaj unë tani. Një ulliri të lashtë, me trung të plasaritur dhe të murrëtyer nga erërat e kohës.

Ullirit i ngjaj unë tani. Një ulliri të lashtë, me degë të gjelbra, që në pranverë çel lule dhe në vjeshtë bën kokrra. Ullirit i ngjaj unë tani.

EMRI YT

Emri yt, nën zë, kthehet në ngazëllim. Emri yt, nën zë, kthehet në psherëtimë. Emri yt, nën zë, kthehet në lutje. Emri yt, nën zë, kthehet në jehonë thirrjeje. Emri yt, nën zë, kthehet në këngë. Emri yt, nën zë, botës i jep emrin tënd.

NATA JONË E PARË

Si thua, a nisemi pas kaq vitesh të kërkojmë natën tonë të parë? Atë natë të argjenduar nga drita e hënës, kur puhia e yjeve të binte mbi sup dhe trupat tanë dridheshin nga zogu i dashurisë, që na rrinte brenda gjoksit.

Ishte nata e takimit tonë të parë, e papërsëritshmja natë, të cilën më kot do ta kërkojmë, sepse ajo kush e di se në ç'hon të kohës ka rënë.

HAPËSIRA E DASHURISË

O ti që re në dashuri për herë të parë dhe thirre: "Ika, ika, mora malet!" Thua se kaq të madhe e kishe harenë dhe dhimbjen, sa vetëm në lartësitë e qiellit mund të merrje frymë lirisht dhe të gjeje prehje.

KADAREJA TJETËR

tregim

Agron Bajraktari

„Ai ecën si të tjerët, pastaj ngjitet nëpër shkallën prej alumini. Te porta e avjonit ul kryet për të mos u përplasur dhe ashtu, kokulur, e gjen ndenjësen e vet. Lëshohet në të, lidhet me rrip dhe mbyll sytë. Ëndrra e arratisjes ka marrë fund.“

— "Kohë e pamjaftueshme", Helena Kadare

Marku më mori në telefon në një të natës dhe me zë plot ankth, thua se dikush i kishte vënë tytën në kokë, më tha:

“E dije ti se Kadareja donte të arratiset në 62-shin?”

Pyetja qe po aq absurde sa dhe ora kur po më telefononte. Ai e dinte shume mirë se më duhej të zgjohesha në gjashtë të mëngjesit që të shkoja në punë.

“Jo,” i thashë, gjithë nerva. “Supozohet ta dija?”

Nga ana tjetër erdhi një psherëtimë e rëndë, të cilën ia njihja mirë. Në mënyrën e tij të zakonshme, ai po ankohej se nuk ia kuptoja asnjëherë pasionet.

Në të vërtetë, Marku kishte vetëm një pasion: Kadarenë. Nuk kishte fjalë të shkrimtarit të madh që ai nuk e kishte lexuar. Madje, njëherë pat bërë kërkesë në arkivin e shtetit për të shtënë në dorë dokumente dhe dorëshkrime të vjetra të tij, por Arkivi, siç pritej, ia kishte refuzuar kërkesën.

Që të mos e mbyllja atë natë me të keq, i thashë:

“Nesër në gjashtë, te vendi i përhershëm?”

Me një tundje koke, pasi përgjigjen e tij mund ta përfytyroja pa e parë, Marku lëshoi një “po” të lumtur, si ajo e fëmijës kur i plotësohet dëshira. Pastaj e mbylli.

Vendi i përhershëm qe një kafene e vjetër, ku, sipas fjalëve të Markut, për të cilat ai betohej se qenë të vërteta, Kadareja kishte shkruar një pjesë të madhe të veprës së tij. Simotrën e saj, Rostandin e famshëm, ende s’kishte mundur ta vizitonte, kryesisht për arsye financiare.

Kafeneja gjendej diku afër hotel “Dajti”, e fshehur në një cep gati të padukshëm, që mund ta gjeje vetëm nëse dije ç’kërkoje. Sikundër të tjerave, ajo nuk kishte emër dhe mes nesh njihej thjesht si “Kafeneja”. Pikërisht ky mosemërtim kishte qenë dhe arsyeja pse Kadareja e kishte zgjedhur atë kafene, thoshte Marku me sigurinë që e karakterizonte sa herë binte fjala për të. “Është kaq e thjeshtë,” shtonte ai. “Vetëm ai që s’do të kuptojë s’e kupton.”

Në orën gjashtë, unë u gjenda te kafeneja dhe aty, duke më pritur prej kushedi sa minutash, gjendej Marku, i humbur në një nga librat e Kadaresë. Këtë herë, më duket, qe një përmbledhje e vjetër me tregime dhe novela; nga fleta e hapur munda të vjedh me sy fjalën “Ur-libri”. Me t’u bërë i vetëdijshëm për praninë time, ai e mbylli librin dhe e futi në një strajcë, ku arrita të kap disa tituj të tjerë, ndër ta edhe Qytetin e Jugut.

“Faleminderit që erdhe,” arriti të thoshte ai, para se të na porosiste nga një kafe. “Pra, e more vesh? Se si Kadareja paska dashur të ikte në 62-shin?”

Pavarësisht lodhjes nga puna, pasioni i atij njeriu për dikë tjetër, të cilin, me sa dija, s’e kishte takuar kurrë, ishte tepër interesant. Të tërhiqte

pas vetes si një magnet. E më interesante ishte mënyra si harronte se kishte qenë ai vetë që më kishte vënë në dijeni për atë ikje të supozuar të Kadaresë, të cilën tani po ma vendoste në tavolinë sikur të kishte qenë tema e ditës në të gjitha kafenetë e Tiranës.

“Po, po,” ia mbajta ison. “E mora vesh. Po ti, ku e dëgjove?”

Këtu ai u tërhoq pas, u mbështet në karrige duke mbledhur supet dhe buzët i morën formën që i merrnin zakonisht kur zhgënjehej me veten kur diçka i kalonte pa vënë re.

“E lexova te libri i së shoqes.”

Fjalja qe e thatë, siçdo gjë që ai thoshte për të shoqen e Kadaresë. Pavarësisht se ideja ishte marroke, sjellja e tij, sa herë binte fjala për të, më bënte të dyshoja mos ai ishte xheloz. Gjë që më bënte të dyshoja gjithashtu se mos ishte homoseksual, për të cilën nuk kisha vënë re ndonjëherë shenja.

“Pra,” vendosa ta ngacmoj, “vendose më në fund ta pranosh edhe atë në mesin tuaj?” Duke nënkuptuar me *tuaj* Markun dhe Kadarenë.

Marku buzëqeshi idhët, sikur po kapërdinte diçka me zor, pastaj ma ktheu:

“Nuk e di as vetë. Po çërmoja nëpër raftet e një librerie të vjetër diku te Blloku, kur, befaz, në gjysmën e një kopertine, m’u shfaq emri Kadare. Por ç’e do, qe Helena.”

Mënyra si i thërriste me emrat e parë nuk më bënte më pershtypje. Tani e merrja si diçka te mirëqenë, që ai e bënte pa të keq.

Marku vazhdoi:

“S’e di as vetë ç’hyjni më shtyu ta merrja atë libër në shtëpi. E fillova aty nga mbrëmja, si rastësisht, ngaqë nuk po më bëhej të lexoja shkrimet e vjetra. Derisa hasa faqet ku shpjegohej gati-arratisja e Ismailit, pas të cilave, pastaj, mora ty në telefon.”

Minutat në vazhdim u mbushën vetëm nga zëri i Markut, një zë bariton, herë i thellë herë melankolik, që ulej e ngrihej mbi rrëpirat e një historie që kishte ndodhur këtu e gjashtëdhjetë vjet më parë.

Siç duket, Kadareja kishte dashur përnjëmend të arratiset në 62-ishin. Unë nuk e kisha ditur asnjëherë këtë fakt, e ajo çka më habiti më shumë qe se as Marku s’ia kishte pasur idenë.

“Në asnjë prej librave të tij - dhe besomë, i kam lexuar të gjithë - s’e kam lëçitur këtë ngjarje.”

Marku më betohej me shpi e katandi se kështu ishte e vërteta, edhe pse, pavarësisht se mund të vija dorën në flakë për ekspertizën e tij kadareane, nuk

mund të bëja të njëjtën gjë për aftësinë, ose më saktë, paaftësinë e mendjes njerëzore që të mbante mend çdo informacion në formë të pastër. Kishte shumë mundësi që ai ta kishte lexuar dikund atë histori; në ndonjë tregim a intervistë, Kadareja, me siguri, në atë mënyrën e vet enigmatike dhe të fshehur, e kishte rrëfyer. Thjesht Markut i kishte shpëtuar. Këtë, sigurisht, Marku nuk mund ta pranonte kurrë, kështu që këmbëngulte si mushku se ajo histori ishte rrëfyer për herë të parë dhe të vetme në librin e Helenës. Madje, betohej se Ismaili e kishte ruajtur ekskluzivisht për librin e saj, thua se ai kishte qenë në dhomën e tyre të gjumit ndërkohë që ata e kishin planifikuar.

E përmbledhur shkurt, historia qe kjo:

Kadareja kishte parë një mundësi arratisjeje kur qe bërë pjesë e grupit që do shkonte në Festivalin Botëror të Rinisë në Finlandë. Nuk i kishte treguar askujt, përveç një shokut të ngushtë, i cili e kishte siguruar se po bënte veprimin e duhur.

Udhëtimi kishte zgjatur tre javë, katër ditë prej të cilave, dy gjatë ikjes dhe dy gjatë kthimit, i kishin kaluar në Pragë. Pikërisht atje vendos Kadareja të arratiset. Pikësynim ka Rusinë, edhe pse Perëndimi është ëndrra e tij. Por gjuha, tëhuajësia që ndjen ndaj perëndimit, pavarësisht dashurisë që ka për të, e bëjnë të anojë drejt asaj që njeh më mirë.

Me të mbërritur në Pragë, ai vihet në kontakt me ambasadën ruse dhe pret derisa ata t’ia aprovojnë azilin politik. Fakti që është shkrimtar, më i njohuri në vendin e vet, e për më tepër ka edhe një libër me poezi të botuar në rusisht, ia shpejton “po-në” e ambasadës, e cila e fsheh në një hotel si nënshtetas spanjoll. Atje, në atë hotel të huaj, ai pret ditën tjetër, që të ikë, më në fund, drejt Rusisë.

Mirëpo, arratisja nuk ndodh. Diçka, se ç’ka Marku s’dinte ta përcaktonte mirë, ia kishte marrë këmbët dhe e kishte bashkuar prapë me grupin shqiptar. Mëdyshjet e kishin ndjekur deri në aeroport, ku dhe kishte menduar se mund ta bënte arratisjen në çastin e fundit, duke u fshehur në ndonjë tualet. Por as këtë s’e kishte bërë. Prapë ajo gjëja e papërcaktueshme e kishte ndaluar ta merrte atë hap. Në fund, ai kishte hypur në avjon dhe qe kthyer në Shqipëri.

Në fund të rrëfimit, Marku u mbështet fort në karrige. Merrte frymë thellë dhe rëndë, sikur sapo të kish mbaruar një maratonë. Në ballë i valëzonin ca pika djerse.

“E kupton se çdo të thotë kjo? Kadareja ka qenë duke vrarë Kadarenë!”

Bëra sikur e kuptova dhe prita që ai të shpjegohej vetë.

“Pa imagjinoje! Ajo ikje do kishte qenë vetëvrasje për të. E ç’të mira do i kish sjellë Rusia? Ku mund ta dish ti që atje do bëhej më mirë? Mendon ti vallë se ‘Kronikë në gur’ mund të shkruhej kund tjetër përveçse në Shqipëri? Gjithë natën veç këtë kam menduar. *Prëmë s’më ka zënë gjumi.*”

Tani që po e përmendte, vërtet ashtu më dukej. Poshtë syve të tij qenë krijuar ca rrathë të zinj, rrathë ankthi dhe merak.

“Gjithë kohën mendoja për degëzimin e jetës së tij. Se si në fakt ashtu ndodh degëzimi i çdo jete. Një vendim dhe çdo gjë merr një rrjedhë tjetër. Është e frikshme, Anton. E tmerrshme. Ku ta di unë se nuk e kam marrë tashmë një vendim si ai i Kadaresë, ose më saktë, një kundërvendim; domethënë, një vendim që më ka çuar në Rusi, ndërkohë që e ardhmja ime e vërtetë, ajo e arta, më priste në avjon. E kupton dot?”

Pak nga pak po e kuptoja. Dhe për një çast, u ndjeva më mirë. Jo për faktin se miku im po vuante nga një problem që e kishte nxjerrë nga asgjëja. S’mendoja ta fusja ndonjëherë në karakter konceptin e *Schadenfreude*-s. Ajo që më gëzonte qe fakti se ai po e përdorte atë histori, ngjarjen e gati-arratisjes së Kadaresë, për të përfunduar tek vetja. Fiksimi ndaj dikujt tjetër, të paktën për



mua, ishte disi më i dëmshëm sesa fiksimi ndaj vetes. Në rastin e parë, ekzistonte mundësia që të lëndoje dy vetë, ndërsa në të dytin vetëm një.

“E kuptoj,” i thashë. “Gjithsesi, ne s’kemi nga ta dimë se vepra e tij s’do ekzistonte, të paktën në formën që ka tani, nëse do qe arratisur drejt Rusisë.”

“Kemi, si s’kemi. E ka thënë vetë: *‘As kockat s’do m’i kërkonin po të merrja atë rrugë’*, a diçka të tillë.”

Për disa çaste, ai u përpoq të gjente fjalët e sakta që kishte përdorur Kadareja. Kur s’ia doli dot, iu rikthye temës së degëzimit.

“Mbrëmë s’kam fjetur, po maktë kam parë. Më shfaqeshin, si hije të kobshme, titujt e ri ose të lënë përgjysmë të veprave të tij. Nëpër fletore gjithëfarësoj, me kopertina të zhgarravitura në rusisht, më dilyn para syve: “Kronikë e lënë përgjys”, “Gjenerali i ushtrisë së arratisur”, “Ura e pambaruar”, “Pallati” me një vizë përmes, “Ra ky mort e s’u pamë”; ose jo: “Ra im-mort e s’më panë”. Vetëm “Dimri i vetmisë së madhe” më dilte ashtu siç është në të vërtetë. Pastaj këto hije materializoheshin e binin si breshër mbi krevatin tim dhe unë i hapja, i shfletoja një nga një e nuk gjeja asgjë. Të bardha, ato fletë qenë të bardha. Si bora e Rusisë. Bosh. Jeta e tij, e të madhit, bosh.”

Fjalët e tij ishin me të vërtetë të ndjera. Ai njeri vuan nga ëndrrat më shumë se nga jeta e njëmendtë.

“Ti e di se kë çmoj më shumë nga ato që ka shkruar Kadareja?”

Qoftë dhe përpjekja më e vogël për ta menduar diçka të tillë qe e kotë. Ishte e pamundur t’ia qëllonte dhe mendoja se as ai vetë s’e dinte këtë gjë.

“Ur-libri. Është një tregim i 86-s. I shkurtër, por aq i bukur. Mendoj se nuk ka shkruar gjë më të bukur se ai tregim. Imagjinoje tani 86-ën e largët. Kadareja tjetër në Rusi, ose i vdekur me kohë, pasi kushedi çdo i kish ndodhur gjer atëherë. Ndoshta dhe do kishte vdekur nga brenga dhe dhimbja për fatkeqësinë që i kish shkaktuar familjes dhe... Helenës.” Fjalën e fundit e shqiptoi ngadalë, pjerrtazi. “Ai tregim s’do ishte shkruar kurrë në atë gjendje. Në atë mërgatë absurde. Dhe unë, unë s’do e lexoja kurrë Ur-librin.”

Aty për aty, iu rikthye prapë degëzimit të jetës.

“E kupton dot se ç’paralizë të shkakton ky mendim? Se si një vendim i vogël, patetik, mediokër, një kthesë e tepërt ose e mangët, të ndryshon jetën, se si Ur-libri yt mund të mos jetë fare! Të kam treguar për Anën?”

Më kishte treguar me qindra herë, por mënyra si ia thoshte emrin, gjithë pendësë e dashuri, nuk më lodhte kurrë.

“Ja, për shembull, historia ime me Anën. Sa ndryshe do kishte shkruar nëse unë do kisha vepruar ndryshe, nëse do isha kujdesur për të siç duhet? Nëse do e kisha dashur siç ajo e meritonte?”

Pak nga pak, në rrathët e zinj poshtë syve filloi të reflektohej drita e vakët e kafenesë. Marku po rrëmbushej. Për t’ia kursyer sikletin, thirra kamerierin për një kafe të dytë.

Për një copë kohë, ne ndenjem në heshtje. Dora e djathtë e Markut, instiktivisht, qe mbështjellë rreth strajcës ku mbante librat e Kadaresë, ndërsa e majta qe varur poshtë nofullës së tij të gjërë.

Historia e tij me Anën qe e trishtë dhe lëvrimi i mëtejshëm i saj, që e kishim bërë me qindra herë, veçse do ia shtonte vuajtjen.

U përpoqa të ndërroj bisedë, por qe e kotë. Sado që mësyja drejt përditshmërisë sime, apo ndodhive banale të punës, ai rikthehej te gati-arratisja e Kadaresë. Veçse tani pak më vakët. Tronditja e saj sikur po ia linte vendin diçkaje tjetër, më të vjetër, që në fakt aty kishte qenë, veçse e fshehur, e veshur me petkun e përpjekjes për arratisje të shkrimtarit të tij të preferuar.

Nuk e di sa ndenjem ashtu, ai duke iu rikthyer çdo detaji të asaj që do kishte qenë nëse Kadareja do qe arratisur, ndërsa unë duke e dëgjuar në heshtje, me sytë që më shkonin herë pas here te strajca e librave, *gjersa erdhi kamerieri dhe ne, për habinë e tij, porositem nga një kafe të tretë.*



ZEZONË

tregim

Behar Jacaj

Pranverë. Stinë lindjesh. Çehra e qiellit ndryshon rrufeshëm si humori i një gruaje që pret të bëhet nënë. Është pasdite fundmarsi kur dita sapo ka filluar të hedhë shtat si fëmijët në adoleshencë. Dera e “Kafe Muzgu” shtyhet dhe tërhiqet vazhdimisht. Shtuni, një shkrimtar i vetëshpallur, qëndron fillikat në qoshe, në një nga ndejset e larta pa shpinore, përbri banakut. As një qind centimetra larg tij, një çift po përlëshet me sikletin dhe ndrojnë e takimit të parë. Biseda e tyre arrin lehtësisht në veshët e Shtunit. Vajza flet vazhdimisht, rrallë dëgjohet zëri i djalit. Si duket, djali ka frikë të gabojë ndërsa vajza ka frikë të heshtë. Matanë xhamave qielli nxihet edhe më. Mendimet e Shtunit gjithashtu. I bëhet sikur shikon një mi që, nxitimthi përvidhet nëpër këmbët e njerëzve poshtë tavolinave. Kushedi pse, në vend të neverisë ndien një farë simpatie për atë krijesë vocrrake. Ndoshta, ngaqë sëfundmi, gjithnjë e më shumë është i rrethuar nga minjtë. Me humor të zi i quan “miqtë e mi besnikë”. Një vetëtimë, që përdridhet në qiell si një gjarpër i flaktë, ia tërheq shikimin matanë qelqeve. Megjithëse nuk bën ftohtë, instiktivisht mblidhet brenda xhakës. Është e pamundur, mendon, që njeriu të shikojë një qiell të ngrysur pa ëndërruar ngrohtësinë e një strofkulle. Kthen të gjithë lëngun që mban gota dhe porositi një tjetër. Siç bën zakonisht kur është i dendur me konjak dhe trishtim, nisi të filozofojë. Gjuha vete ku dhemb dhëmbi dhe mendimet ku qan shpirti. Dështimet janë vaji i përhershëm i shpirtit të tij. Diku, dikur kishte lexuar, a dëgjuar, se të dështosh në letërsi është fatkeqësi. Ta dish se je dështak, është dyfish e tillë. Nga dreqin rrjedh gjithë ai dështim? Ai i ka provuar të gjitha. I ka veshur shkrimet e tij me mjegull dhe enigmë që të zgjojë tek lexuesi kuriozitet. I ka lënë përgjysëm që të ngjallin intrigë, ka sharë heronjtë dhe profetët për të ndezur debat, por sa vdekja e një milingone ia kanë vlejtur të gjitha këto. Asgjë s’ka arritur. Përjashta fillon të derdhet një shi inatçor. Në tavolinën ngjitur, vajza, që dukshëm ka fituar vetbesim dhe territor, i bën djalit një provokim të lehtë. Provokimi fshihej pas një kroasanti.

-Nëse nuk e ke bezdi përfundoje ti, nuk e ha dot të gjithën, - u dëgjua plot dredhi zëri i së panjohurës. Tani po luhet hapur, mendon Shtuni. Provokimi dhe propozimi është i qartë. Bashkim buzësh. Puthje nëpërmjet një kruasanti. Djali, çuditërisht, refuzon. Budalla, mërmërit Shtuni dhe hap bllokun e shënimeve. Edhe shënimi i fundit në bllok është për minjtë. “*Mbi kurrizin e një miu*” shkruhet me shkrim të ç’rrasët, në formë titulli. Pastaj, pa zë lexon ose më sakt, rilexon : “*Nuk dihet nëse minjtë sollën murtajën apo murtaja solli minjtë. Dihet vetëm se është shekulli i miut. Njeriu shalon miun sikur të ishte Pegasus dhe fluturon nga një kontinent në tjetrin, nga Everesti në Sahara, nga skamja në tepricë. Dhe të gjithë këtë udhëtim e bën pa i ngritur të ndenjurat nga sfungjeri i butë kolltukut. Njeri i shekujve të shkuar, mbi Kurrizin e kalit, bënte udhëtime, marshime, luftëra, spiunime, komplete. Të njëjtat gjëra bën edhe njeriu i brezit të ri, veçse kurrizin e kalit e ka zëvendësuar me kurrizin e një miu fisnik të quajtur “mouse”. Thuhet (të vërtetën e di vetëm Zoti) se kalorësi i moçëm krijonte një ngjashmëri të çuditshme me kalin e tij. Të njëjtën ngjashmëri krijon edhe njeriu i sotëm me pegasusin e tij, miun. Rri i fshehur si miu, bluan dhe bren jetën e të tjerëve, futet fshehurazi (jo edhe aq në fakt) në dhomën e grave dhe shkrihet duket përgjuar trupin e tyre të lakuriqtë...”* Shënime të lënë përgjysëm, thajse dorëshkruesit i ka rënë të fikët, ose ka vdekur aty për aty. Kuptohet, frymëzimi për minjtë është i brishtë, fiket lehtë (ndoshta nuk ndezet kurrë). Përjashta qielli është paqtuar dhe muzgu, si një anije që e sjellin dallgët e detit, sa më shumë afrohet aq më shumë zmadhohet. Përbrenda, njerëzit janë kthyer të gjithë në minj. Shtuni është i bindur që truri nuk po i bën asnjë lojë. Njerëzit vërtet janë shndërruar në minj. Buzët e vogla që lëvizin shpejt duke bluar biseda shterpë si rroba të mykura, barqe të dendura, që për shkak të pozicionit duken edhe më të gjera, shikime shpuese si shikimet e minjve. “Kafene minjsh” mendon Shtuni dhe përpun molekulat e fundit të mbetura në gotë. Rreket që këto mendime t’i rreshtojë përbri shkrimit të lënë përgjysëm, por ato nuk i binden kurrsesi. Ka kohë që trurin ia çukit mendimi për të shkruar një poemë për veten, për putanat, për gruan e ikur dhe për ndërmarrjen e pastrim-gjelbërimit. Një poemë për dështimin. Një poemë për jetën e tij mjerane. E ku mund të gjente një vend më frymëzues sesa atë kafene minjsh për të shkruar për gjëra aq të shpifura?! Megjithatë nuk shkruan asnjë gërmë. Çifti pas shpinës së tij nuk është më atje. Ka ikur pa i bashkuar buzët, qoftë edhe nëpërmjet një kroasanti. Sheh orën. Mungon edhe një bashkim akrepash deri në fillimin e punës. Porosit një kafe si për të qetësuar trandjen që ndien në kokë. Ja, përsëri ai miush nxjerr hundën e tij majuce mes shisheve të ekspozuara mbi përtej banakut. Aroma dhe shija e kafes e gjallërojnë disi. Kur në fund të filxhanit mbetet vetëm një llum i vogël, si batak i një kënete të tharë, paguan dhe ngrihet. Kur del jashtë, qiellit i ka shteruar shiu. Toka e bulëzuar dhe ajri i njomur ia freskojnë të gjitha porët e lëkurës. Ai ajër i lagësht bën me trurin e tij të njëjtën mrekulli që bën me lulet, e gjallëron të gjithin. Ecën me hapa të matur, duke marrë frymë thellë sikur të ketë zbuluar për herë të parë ajrin. Pyet veten se çfarë epiteti mund t’i vejë ndjesisë që i fal ai ajër i begatë. Të gjitha epitetet i dalin të sforcuara, të papërshtatshme. I bëhet sikur ai ajër, ai moment është një shëmbëlltyrë e parajsës. Gati-gati bindet se po merr frymë nga fryma e Zotit...

Nga këto mendime e shkëput përdhunshëm një mace sterrë e zezë, që i pret rrugën dhe zhduket sërishmi në errësirë. Mend e lë zemra nga frika. Vrik ndryshon rrugën. Ç’ishte gjithë ajo frikë?,- mendon tek mundohet të qetësojë frymëmarrjen. Edhe nga se, nga një mace? Thuamë me kë rri, të të them se kush je, përgjigjet po vetë. Mos vallë jam kthyer në një...Nga ky mendim i shkojnë mornica në trup. Merr frymë thellë, por nuk ngopet me ajër. Ajri e ka humbur magjinë. Fryma e Zotit ka avulluar. Qyteti është kthyer sërish në një zezonë të pështirë me mace e minj.

SKULPTURË

Në shesh të botës ti digjesh fërfëllim,
diellit luftë i shpall me vështirim stoik,
kokat kthejnë teje, mbushur përdëllim,
shiun bën furtunë, furtunen – armik’.
Her’ si trup pa gjak, her’ si det i fjetur,
frymëmarrjes së natës ngarkon mirësit’,
herë në gjallëri, herë me zë të mekur,
kërcimtar’ të dhimbjes, befas të zënë prit’.
Bebëzave të syrit mbirë si sythe majesh
gdhendur ballin hënë, ti heshtje krenare,
bota hyn në ty, ti e zhveshur fajesh,
tek të mërmërisin: “Ç’bukuri vrastare!”
Herë merr forma femrash, trajta ajri merr
tek t’vrasin me zë, tek t’therin pa fjalë,
dhe të përgjërohen, dhe të bëhen terr,
ca thonë “Shën Mëri!”, ca thonë “E përdalë!”
Herë u bëhesh grua, herë shfaqesh hyjni,
përbuzjen-shigjet’-ngulur, brinj’ më brinj’,
i kaplon dëshirë, i zgjon në zili,
her’ të hedhin dimër, her’stinë përmbi stinë.
Enden muzikë lutjesh në çdo cepin tënd
dhe të nisin shira, dëborëra përmbi,
të puthin, të ndukin, me mend e pa mend,
dhe të veshin vello, dhe të vënë në zi.
Herë përflakesh qiellit, herë në rrapëllim’,
vështirime meskinësh puthin kurmin tënd,
herë bëhesh ciklon, herë ylber në zgjim
e prapë rri statujë në po të njëjtin vend.
Ja, kështu lufton, e gdhendur mermer,
herë del triumfale, herë helm e vrer,
në varr i shpie, të çojnë disa herë,
me miliarda shekuj, me ty, besë-e-prerë.
Nga zgavrat e syve i sheh përcëllimë,
kur në dritë i var, në kryq të mendojnë,
mbi ty ditët bien, të rënda pikërrimë,
herë i kryqëzon, herë të kryqëzojnë.

NATË

Dritat e qytetit hapen si kamare të ndezura,
thëngjij të kuqërremtë që feksin verbonjës,
por as na ngrohin, as na ndriçojnë plotësisht,
veç përplasen lehtas në një gëzof ere të tejdukshme.
Është era jonë.
Dhe hapet nata, dalëngadalë, e pafajshme,
e rëndë si perdja përpara shfaqjes premierë.
Tronditen mugëtirat, mantelet e agimeve, përgjakur,
s’njihen, nata i mbështjellë.
Së lartmi, yjet purpur formojnë qytetin e tyre sfidant!
Qytet e qiell përndizen në terr.
Pothuajse zvarrë një muzikë sensuale rënkton e dro-
bitur
dhe përshëndetet nga zërat tanë që klithshëm për-
plasin duart si shtrëngata pranvere.
Në çdo manastir të braktisur, murgjit varin-mozaikë
në mur-qefinët e vdekjes
dhe qirinjtë digjen tinëz si shpirt vashe të dashuruar.
Një leckaman numëron muzgjet tek shqyen mëngët e
pasanikëve
dhe me ngazëllim i bashkohet errësirës,
sytë i marrin ngjyrën e saj
deri te pika e kthesës, kur bashkë me harabelat
gëzon gjumin poshtë urës qindra milionëshe të
kryeqytetit.
Pasmesnatë! Pllajat e buta marrin forma trupash
njerëzorë-të heshtur deri te majat e thonjve,
nën mbretërinë e zisë lulëzojnë së brendshmi dhe u
zgjohen të fshehtat, të ndaluarat, të frikshmet.
Edhe patat e egra që zhurmojnë, kanë fjetur si çdo
herë në këtë orë,
shpezët e tjera janë strukur herët nëpër strofullat e
tyre...
perandoritë humane, bien pabesisht,
megjithëse ndërtuar mbi drurë hinoki...
Bie gongu!
Zhytur mallëngjimeve,



PA STREHË MALLI

poezi nga

Majlinda Rama



njerëzia kumbon si zë i shkretë mes malesh
dhe ashti u çahet si det i terur
dhe shohin njëri - tjetrin të zverdhur në fytyrë
dhe nisen...
Shtegtimi dhemb po aq sa qëndrimi!

EROS

Natë erosi në shtratin tonë
trupat tanë lakuriq hyrë te njëri - tjetri
dhe s’na depërton as koha, as errësira
nata, jo se jo.
Unë nis të fluturoj përmes gojës sate,
drejt hapësirave të tua,
aty brenda kthehem në zanafillë
dhe bëhem gati për rrugën e këtij çasti,
ti rrëshqet kofshëve të mia të marrësh fuqi burri ...
Të pashqetësuar nisim startet tona drejt qyteteve
brenda nesh,
dritare më dritare vendosim nga një flatër-puthje.
Në fillim trupi yt prej mali bëhet njësh me brishtësinë
time
dhe çmendem...
dhe marr trajtën tënde.
Pastaj, më fton të hyj në ty
dhe ky trup i vogël gruaj
hyn në burrin e pritur prej shekujsh
dhe bëhemi njësh
dhe ti çmendesh...
Dhe vuajmë paqësisht,
gjakrat nisin harbimin e bashkohen nëpër vena
pastaj lëkurët tona lëvizin vendit
prej epshit, prej afshit, prej nxehtësisë, prej alkimisë



së zjarrit...
dhe skuqemi
dhe digjemi
dhe ti rritesh
(dhe unë bëhem edhe më shumë TI)
Dhe s’dimë çfarë është jotja e çfarë imja
vetëm e bardha e çarçafëve na ndan sinorët sipër-
faqësisht
çdo gjë tjetër na bën bashkë
dhe nëpër natë thurim himne dashurie
të pafundme
deri në përjetësi!

PAVARËSISHT TË GJITHAVE

Pavarësisht të gjithave,
e kam ditur
që, nëpër shtegun e ballit njerëzor, kalojnë mijëra
ditë të hedhura dëm,
e kam ditur që, në sytë e qenies, trokasim dhjetra
ylbere mjegullash,
që, në fustanet e nuseve të reja, vulosen mjerisht
mbresa e kënaqësi burrash çfarëdo,
e kam ditur
që mirësia mbetet qëllim i dështuar i çdo mbrëmjeje
dhe hënë e përjetshme rëndon plumb mbi shpinë
si gjëmimi.
Mbi qepallat e njerëzve lexohen peizazhe të ngrira
ëndrrash, pastaj edhe erërat që bien aromë qumështi
gjijnsh
e portokajsh të kalbur,
mbirë nga tokë beronjë.
...
Dhe ti sheh si thinjen kohët, si plakat e bulevardëve
barbare,
zhvishen si vajza të përdala rrugësh,
dhe fati i tyre në kryqëzim
të pëshpërit në vesh
“kohët janë stuhi, stuhi dhe ikje”.
Pastaj, çdo ditë, sheh si përçahen bukuritë,
himnet mortore këndohen në çelje dasdash
mbrëmjeve u shkulet nga një dimër motak
dhe çdo nate i varet nga një nuskë
për ardhje të mbarë të së nesërme...
Pastaj sheh pikëla, hënëza, yje të veçuar,
tek hidhen, palohen, rrëshqasin, zgjaten qiell pas
qielli
dhe shpresa rritet si lastar
e bota e vërvit në hiç.
Pavarësisht këtyre,
janarët vijojnë të zvarriten shpresëmëdhenj drejt
dhjetorëve,
derisa fiken,
polet e fshat-qytet-shteteve bashkohen
dhe gjithë bota mblidhet në një pikëz.
Dhe njeriu i pjek me sy,
të gjitha,
dhe s’bëzan
as kur mbi gërmadha pikojnë,
çdo çast,
pinjollë tufanesh
fëmijë stuhish, syferinash,
stinë të ngrira, acare shpirttrash
endacakë pa strehë malli.
Të pambrojtur shohim
kobin e madh që vrapon mbi njerëz,
mbi ndërtesa, mbi rrugë, mbi makina, mbi lodra,
mbi mite, mbi gjëra të shenjta
dhe gjithçka lëngon
mbi jehona
që shpërthejnë nga gojë qytetesh fatale.
...
Më vonë mësova ç’nuk dija,
mësova shtegun misterioz të grave
prej nga ku kalonin burrat për dorëzimin e shpirtit...
E zbulova nga vinte vdekja...



Samuel Beckett

Atë pasdite, në "La Closerie des Lilas", do të veçoja më shumë një koment nga të tjerët dhe jo vetëm sepse na zbulon shumë Beckett-in si njeri, por flet për dilemën me të cilën duhet të jetojnë të gjithë shkrimtarët: dyshim i përjetshëm, paaftësi për të çmuar atë që ke krijuar".

PAUL AUSTER: SI U TAKOVA ME SAMUEL BECKETT-IN

Në Paris u shpërngula në shkurt të vitit 1971, disa javë pas ditëlindjes sime të 24-t. Atëherë kisha ca kohë që shkruaja poezi dhe rruga që më çoi drejt takimit tim të parë me Beckett-in, nisi me Jacques Dupin-in, një poet të cilit ia përktheja veprat që kur isha student në New York. Ne u bëmë miq të ngushtë në Paris, dhe meqenëse Jacques punonte si drejtor i botimeve në Galerinë Maeght, u takova me Jean-Paul Riopelle, piktorin franko-kanadez që ishte një nga artistët në galeri. Prej Jean-Paul takova dhe Joan Mitchell-in, piktoresh amerikane me të cilën ndante një shtëpi që dikur e zotëronte Monet, në qytetin Vétheuil. Vite më parë, Joan ishte e martuar me Barney Rosset, themeluesin dhe botuesin e Grove Press, ndaj ajo njihej mirë me Beckett-in. Një mbrëmje, rastisi që bashkë me të po diskutonim për veprat e Beckett-it, dhe kur ajo kuptoi se sa rëndësi kishte për mua, ngriti sytë dhe tha, "A dëshiron ta takosh?"

"Po", iu përgjigja. "Sigurisht që po".

"Atëherë thjesht shkruaj një letër", më tregoi ajo, "dhe thuaj që ishte ideja ime".

U ktheva në shtëpi, shkrova letrën dhe tri ditë më vonë mora një përgjigje nga Beckett-i, ku më informonte që ta takoja javën tjetër te La Closerie des Lilas.

Nuk e mbaj mend se ç'vit ka qenë. Ndoshta 1972 ose 1974. Por le të marrim mesataren dhe të themi se ka qenë viti 1973.

Pas këtij takimi e pashë vetëm një herë tjetër – në një vizitë të radhës në Paris, në vitin 1979 – dhe përgjatë viteve kemi këmbyer një duzinë shënimesh dhe letrash. Vështirë ta quaj miqësi, megjithatë duke marrë parasysh admirimin që ndieja për

veprën e tij (kur isha i ri kjo ndjenjë gati shkonte në idhujtari), takimet me të dhe korrespondenca sporadike, për mua ishin jashtëzakonisht të çmuara. Mes grumbullit të kujtimeve, do të përmendja ndihmën bujare që më dha kur po bëja përmbledhjen e *Random House Book of Twentieth-Century French Poetry* (për të cilën kontribuoi me përkthime të Apollinaire, Breton dhe Éluard); fjalimin prekës që mbajti një pasdite në një kafene në Paris mbi dashurinë e tij për Francën dhe se sa me fat ndihej që e kishte kaluar jetën e tij si i rritur aty; letrat miqësore dhe inkurajuese që më dërgonte sa herë që i çoja diçka që kisha botuar: libra, përkthime, artikuj mbi veprën e tij. Kishte edhe momente me humor: një rrëfim pa kurrfarë emocioni i vizitës së tij të vetme në New York, ("Ishte tmerrësisht vapë, u vara te parmakët"), të mos të flasim pastaj për fjalinë e paharrueshme nga takimi ynë i parë kur, teksa i bënte shenjë kamarierit, pa arritur t'ia tërheqë dot vëmendjen, u kthye nga unë dhe tha, me atë theksin e tij të butë irlandez, "Nuk ka në botë sy, aq të vështirë për t'i kapur, sesa sytë e kamarierit."

Atë pasdite te La Closerie des Lilas, një koment do të veçoja më shumë se të tjerët dhe jo vetëm sepse na zbulon shumë Beckett-in si njeri, por flet për dilemën me të cilën duhet të jetojnë të gjithë shkrimtarët: dyshim i përjetshëm, paaftësi për të çmuar atë që ke krijuar".

Gjatë bisedës, më tha se sapo kishte përfunduar përkthimin e librit *Mercier dhe Camier*, romani i tij i parë në frëngjisht, të cilin e kishte shkruar në mes të viteve '40. Unë e kisha lexuar librin në frëngjisht dhe e shfaqja entuziazmin për të pa u rezervuar. "Një libër i mrekullueshëm", i thashë. Por Beckett-i tundi kokën dhe tha, "Oh jo, jo, nuk është shumë i mirë. Në fakt, kam hequr rreth 25 për qind nga origjinali. Versioni anglisht do të jetë goxha më i shkurtër sesa ai frëngjisht". Dhe unë i thashë, "Përse do ta bënit një gjë të tillë? Është një libër i mrekullueshëm. Nuk duhet të kishit hequr asgjë". Sërish, Beckett-i tundi kokën. "Jo, Jo, nuk është shumë i mirë, nuk është shumë i mirë".

Pas kësaj, nisëm të diskutonim për gjëra të tjera. Pesë apo dhjetë minuta më vonë, krejt papritur, u zgjat drejt meje, më shikoi në sy dhe foli: "Të paska pëlqyer vërtet? Mendova vërtet se ishte i mirë?"

Mos harroni se ky ishte Samuel Beckett-i dhe as ai nuk e rrokte dot vlerën e veprës së tij. Asnjë shkrimtar nuk e di, kurrë, madje edhe ata më të mirët.

"Po", i thashë. "Mendova vërtet se ishte i mirë".

Përktheu nga anglishtja: David Hudhri



Paul Auster

Në fillim të viteve njëzet në Nju Jork performanca e Elsa von Freytag –Loringhoven rreth seksit, zbrazëtirës dhe trupit përjetoi një sukses sa jetëshkurtër, aq edhe tundues. Pas këtij sukse si Elsa von Freytag-Loringhoven kaloi në harresë. Ajo qfarë e rikujtoi dhe e risolli edhe një herë në dritë jetën dhe veprën e mbretëreshës gjermane Dada, është një biografi e re e saj.

MAMADADA – ELSA VON FREYTAG – LORINGHOVEN

nga JUDITH LUIG

“**M**akinat dhe biçikletat kanë drita edhe pas. Atëherë përse mos t'i kem edhe unë ato aty?”- shprehej ajo.

Gjatë një pasdrekeje në pranverën e vitit 1918, Jane Heap, botues reviste, ku publikonte letersinë moderne të autorëve bashkëkohor, priti një vizitore të çuditshme. Një femër e veshur me një fustanellë skoceze, me bordurë mobiljeje dhe kambale, me një lugë akulloresh në kapelën basket dhe me një unazë në gisht e tëra mbushur me saçme, hyri krenare në studio. Nga gjinjtë e saj dilnin dy vezë të veshura me nikel. -” tregojnë më vonë botuesja e revistës prestigjioze e artistit “*Little Review*” dhe Jane Heap. Vizitorja e Jane Heapit, me të hyrë në dhomën e ndenjes, vodhi ca pulla poste. Madje, duke hyrë demonstroi një sjellje modeleje. Ky qëndrim i saj, bëri që Jane Heap të entuziazmohej menjëherë nga arti i pazakontë i baroneshës dhe në qershor 1918, ta prezantonte Elsa von Freytag-Loringhoven në “*Little Review*”.

Që në këtë moment ajo u bë ikona e revistës. Ajo e jetonte jetën ashtu si botuesja e saj, “No Compromise with the Public Taste”. “Nuk ka kompromis me shijet publike”. Ajo ishte vetvetja — Elsa von Freytag Loringhoven – provokuese, gjeniale, poeteshë e rrallë, piktoe, modele, recituese, sfiduese, para së gjithash një performuese që rrëmbente çdo çast në çdo kohë, që përveç portreteve të saj, vargjeve dhe objekteve, ajo shndërroi trupin e saj, jetën dhe mënyrën e të sjellurit në një vepër arti, si një provokim kundër vetë shijeve të artit, emrit dhe namit e të qenurit deri asokohe artist.

Në qarqet e artistëve njuyorkezë Elsa von Freytag Loringhoven njihej me emrin Baronesha. Vinte nga një familje qytetare dhe u konsiderua “ikona e Dadaizmit” në Amerikë, ku përveçse gëzoi popullaritet, edhe jetoi që nga viti 1913, deri në vitin 1923. Deri në vitin 1922 ishin botuar vetëm 21 vjersha të saj. Si një pararendëse e performancës dhe e stilit, ajo u cilësua njëkohësisht edhe si shpikësja e artit “ready made”. “E doja botën sepse aty munda të jetoj. E doja botën sepse aty munda të krijoj dhe të bëj art”, shprehej Elsa von Freytag Loringhoven, që nuk reshti së gjurmuar gëzimin e jetës, dashurinë dhe të bukurën. Ajo ishte në kërkim të formave të reja të të vështruarit të botës, të këndvështrimit modern në art dhe të perceptimit ndryshe të gjithçkaje. U mbajt si një thyese e rregullave të gramatikës, të sintaksës dhe të informacionit në gjuhën poetike, krijuese e asaj ndërthurjeje gjuhësore-kimike, përmes të cilave ajo shkruante fjalë të reja dhe kompozime gjithë sarkazëm dhe humor.

Elsa von Freytag Loringhoven pushtoi perandorinë e absurdit, të artit pa logjikë të kthjellët klasik dhe mbeti tërë jetën e interesuar në thyerjen e barrierave të identitetit gjinor. Deri vonë asnjë botues apo media nuk ishte në gjendje të shprehte dhe të botonte dinamizmin e saj. Botimet e saj digjeshin vazhdimisht. Sulme të egra proteste do të vërshonin edhe mbi romanin “Uliksi” të James Joyce dhe në vargjet e çmendura “Madness” të

Baroneshës. Për vjershën “Dashnori i palëkundur”, (shtator 1919), kritikja Lola Ridge do të shprehej “Një sulm vdekjeprurës në art”, ndërsa në vjershën “Mbreti Adam”, (maj 1919) ku në përmbajtje të saj, një femër i kërkonte dashnorit të saj seks oral në shënimet në fund të vjershës, shënohet se vjersha i kushtojë censurës.”

Ndërkohë ishte dhe shumë e varfër. Dada Baronesha ishte një artiste performance, shumë kohë para se kjo fjalë të hynte në fjalor, një poeteshë Dada e orëve të para, që jetoi me moton (*siç u tha më lart*): Nuk ka kompromis me shijet publike. E lindur në një familje intelektuale, si vajza e një mjeshtri ndërtimesh dhe e një pianisteje, në vitin 1887 ajo shkroi vjershën e parë që duhet të jetë të jetë parë në këndvështrimin e një shakaje mbi preferencën e të atit ndaj pornografisë. Nga viti 1894 modeloi si një “skulpturë e gjallë”, si modele nudo në teatrin qendror të Berlinit. Në vitin 1898 ajo arriti të përcjellë motive e stimuj ‘Libido’ te dy vëllezërit Schmitz në Sorrent, pastaj pikturonte piktura erotike në sheshin “Piazza del Popolo” në Romë, e financuar nga një skulptor i vjetër në moshë.

Në shkurt 1900 shkante çdo të enjte në shtëpinë e poetit Karl Wohlskehl në Mynih. Në vjeshtë të këtij viti ajo tashmë ishte nxënësjja, dashnorja, e së fundmi edhe bashkëshortja e arkitektit berlinez August Endell. Në 1902 u shfaq në qiellin e dashurisë studenti Felix Greve, i cili ishte dhe “dielli i seksit të saj”. Por, viti 1903 do shënonte fundin e marrëdhënies, me një përpjekje të bashkëshortin të saj për vetvrasjeje e më në fund në një ndarje.

Më vonë, në Napoli, Romë dhe Palermo, vijuan afëra të tjera me shumë larmi. Me Greven Elsa ajo banoi në



një shtëpi në Étables-sur-Mer, ku autori nobelist francez André Gide, u kujdes për të dy. Aty Felix shkruan një roman me emrin “Fanny Essler”, personazhi kryesor i të cilit nuk mund të ishte askush tjetër, por vetëm Elsa. Ato u martuan që të dy në Berlin, por pastaj Elsa pas një krize nervore kaloi ca kohë në spital.

Bashkëshorti i dytë i saj shkoi në Amerikë dhe Elsa e ndoqi pas. Në vjeshtë të vitit 1911 Felix Greve e braktisi bashkëshortin e tij. Pas kësaj Elsa jetoi me ca afriko-amerikanë në një çadër, ku aty mësoi dhe anglisht. Në dimrin e vitit 1912 u shpërngul në Nju Jork dhe u martua me baronin Leopold von Freytag-Loringhoven, teksa s’kishte bërë ende divorcin me bashkëshortin e dytë. Baroni nuk kishte pasuri, por i dha asaj vetëm titullin aristokrat të baroneshës. Në vitin 1913 filloi një aksion artistik. Gjatë rrugës për t’u martuar me Baronin, Elsa gjeti një unazë hekuri dhe e deklaroi atë si një send nga objektet që koleksiononte si “objekt trouvé”, të “Enduring Ornament”[†] “stolive jetëgjata”. Ky do të ishte më vonë një objekt, i cilësuar si hyrje në historinë e artit. Bashkëshorti i saj u kthye në verë në kohën e luftës së parë në shërbimin ushtarak gjerman, duke lehtësuar Elsen në kursimet e saj dhe ajo e kaloi këtë kohë në Kerker. Fillimi i luftës në Europë e largët duhet t’ia ketë rritur krijimtarinë Elses. Ajo qëndronte si modele, vishte kostume eksentrike, hartonte vjersha,

ngjyroste flokët e saj të shkurtër në një ngjyrë të kuqe verbuese, lyente buzët në ngjyrë të zezë, ngjiste pulla poste në faqe letrash, dhe shëtiste në rrugë me pesë qen të lidhur me një litar ngjyrë floriri me një dritë vezulluese në prapnicë. “Makinat dhe biçikletat kanë drita prapa, atëherë përse mos të kem edhe unë disa të tilla”, thoshte ajo. Në dhjetor 1915 ajo pozoi për “International News Photography” e veshur me pantallona me vija gjer te gjuri, me një bluzë të fantazuar dhe me një kapele piloti, ku kishte ngulur një pendë zogu.

Revista “*Times*” publikonte një artikull të

* “Object trouvé” vjen nga frëngjishtja, ku fjalë për fjalë do të thotë “objekt i gjetur”. Termi hyri në anglisht gjatë fillimit të shekullit të 20-të, një kohë kur shumë artistë sfiduan idetë tradicionale për natyrën e artit të vërtetë. Surrealistët dhe artistët e tjerë, për shembull, thanë se çdo objekt mund të ishte një vepër arti nëse një person ja njeh meritën e tij estetike. “Objet trouvé” mund t’i referohet objekteve të formuara në mënyrë të natyrshme, bukuria e të cilave është rezultat i forcave natyrore, si dhe objekteve të bëra nga njeriu (të tilla si vaska, makina të shkatërruara ose hekurishte) që nuk janë krijuar fillimisht si art, por mund të shfaqen ose rimodelohen si të tilla.

† “Stolia jetëgjatë” është objekti i artit i hershëm i Baroneshës i pagëzuar si “object trouvé” (objekt i gjetur). U tha se e gjeti atë në rrugën e saj për t’u celebruar me Baron Leo von Freytag-Loringhoven në City Hall në New York. Objekti është një unazë e thjeshtë, e ndryshkur hekuri, një zbulim fatësjellës që gjeti gjatë rrugës atë ditë. Sidoqoftë, unaza në fakt nuk funksionoi si unazë martesë, por Baronesha pa në rrethin e saj një simbol femëror. Emërtimi i objektit “sugjeron një lidhje simbolike me martesën e saj (megjithatë objekti i artit do të tregonte më shumë qëndrueshmëri në kohë sesa vetë martesën)”. Baroni u kthye në Gjermani pak para Luftës së Parë Botërore, ku vrau dhe veten.



gjatë, ku ndër të tjera shkruhej: “Forma ime shprehëse e protestës kundër të gjithë shenjave konvencionale.”- siç shprehej ajo vetë. Në dimrin e viteve 1915/1916 ajo banonte në të njëjtën banesë me Marcel Duchamp, me të cilin debatonte gjatë natës. Duchamp e kundërshtonte i vendosur për artin e saj. Në vitin 1916 ajo njohu Djuna Barnes, artiste dhe gazetare amerikane, dhe filloi një bashkëpunim me piktorin Douglas Gilbert Dixon, i cili për shkak të saj u divorcua me bashkëshorten e tij. Në vitin 1917 Elsa bëri një aplikim të pozonte si modele te piktori George Biddle, një piktor 11 vjet më i ri se ajo në moshë, që jetonte në Filadelfia. Porsa u prezantua tek ai, Bidlle donte të shikonte Elsën 43-vjeçare lakuriq. Ajo çkopsiti pelerinën e shiut në ngjyrë të kuqe të ndezur nën të cilën nuk kishte shumë rroba. Në trupin e saj u shfaqën menjëherë kanaçe, salce domateje mbi thithkat e gjinjëve, që ishin lidhur me një lidhëse ngjyrë të gjelbër, mbi ato ishte vendosur një kafaz i vogël me një kanarinë. Në krah kishte unazka perdeshe që i kishte marrë në një dyqan perdeshe.

Porsa hoqi kapelën të stolisur me një karrotë të larë në flori, dolën në pah flokët e saj të shkurtër në ngjyrë zjarri. Në panverën e vitit 1917 Duchamp dorëzoi jo në emrin e tij, por me një emër -pseudonim një objekt nën titullin “Shatërvani” një ‘Urinal’ për ekspozitën e përvitshme të “Bashkimit të artistëve të pavarur”, një prototip të një objekti të përditshëm, që duhej të promovohet si vepër antike nëpërmjet ndryshimit të kontekstit. “Kjo ide e re ishte e një mikeshe të tij”, sqaronte Duchamp kur i shkruante motrës së tij. Dhe kjo mike nuk mund të ishte sakush tjetër, veçse Elsa.

Ndërkohë kalvari i ngjarjeve të pazakonta vazhdonte për baroneshën, ajo u ndoq nga spiunazhi dhe u arrestua për tre javë. Në qershor 1918 “Little Review” prezantoi Elsën. Në paraqitjen që i bëri Elsës, botoi edhe poezitë e saj, e siç u quajt kjo më vonë nga kritika - një “çmenduri” ku protestohej kundër artit të zakonshëm tradicional.

Krahas James Joyce, Elsa ishte për një farë kohe legjenda e “Little Review”, tregonte Heap më vonë. Për qenien e saj si një personazh publik, Elsa e rruante mesin e kokës dhe e ngjyrote tollën e rruar me kallaj. Kulmi pasoi në maj të vitit 1919 me poemën “Mbreti Adam”, ku një femër “klitoriste” e kërkonte dashnorin e saj te “Cunnilingus” dhe bëri që ajo të përndiqej në shumë shtete të Amerikës nga censura.

Shumë vepra të saja nuk e panë dritën e botimit. Tek “Një duzinë koktejlesh” ajo shkruante mbi një kondom:

*S’ka asnjë virgjëreshë Lolly.
-Po,
ne s’kemi asnjë banane,
goja ime lëngëzon
unë i ha ato gjithmonë.
Kanë një zorrë celuloid
në të gjitha madhësitë
të ngjyrosura djallëzorisht
me ngjyrë të verdhë
si majmuni në prapanicë*

Kuptimi i egër, vulgar i performuar si ekspozitë për t’u kundruar në trupin androgjen të saj, shkaktoi një debat mbi seksualitetin femëror dhe forcën mashkullore.

“Art of Madness” (arti i marrëzisë) i baroneshës i ktheu modernistët në sulm kundër dadaistëve. Në prill 1921 Elsa u përfaqësua me një poezi dhe dy imazhe në revistën “New York Dada” të botuar nga Man Ray dhe Duchamp. Të dy burrat botuan një fotografi “Elsa, Baroness von Freytag-Loringhoven, duke rruar organin e saj” Në vitin 1922 Ezra Pound shkruan një poezi Dada për atë. Në maj 1924 Heminguei guxoi dhe botoi kundër vullnetit të botuesit Madox Ford tri poezi të Elsës në “Transatlantic Review”, megjithëse për këtë, ai humbi edhe vendin e punës si redaktor. Aktivitetet eksentrike të Elsës nuk mbetën pa u diskutuar dhe pa sjellë frustrim: Ashtu si turfullonte pareshtur edhe kritikja Lola Ridge duke u shprehur “Një sulm vdekjeprurës



në art”. Në muzeun e artit modern në Nju Jork, në Filadelfia dhe në koleksionet private janë gjetur objekte të “Dada-Lady”, në mes tyre edhe “Limbwish Ornament” të vitit 1920, një pendë metali e lartë 55 cm që lëkundet nga një unazë perdeje e vjetër, e ngulur në një tel të përthyer. Elsa e mbante këtë në vend të një revolveri, të ngulitur në një rrip beli, si një kamzhik për të goditur pjesën e nënbarkut. E armatosur kështu, krenohej përgjatë rrugës “Fifth Avenue”, ku ajo u kujtonte atyre femrave, që do të shkonin te dashnorët, që nuk duhej të harronin kamzhikun. Poeteshja Evelyn Scott vazhdonte ta kritikonte: “Baronesha është një orientaliste nudo që në ekstazën e vetëbesimit të saj bën xheste të pacipa.”

Nga ana tjetër, krejt ndryshe shprehej Jane Heap: “Baronesha është Dada e parë amerikane, është e vetmja në botë, që vishet Dada, dashuron Dadën, jeton Dadën.”

Në prill 1923 Elsa u kthye në Berlin dhe aplikoi pa sukses për një pension si vejushë e një ushtaraku. Nga i ati i ishte hequr e drejta e trashëgimisë. Pa asnjë të ardhur ajo përshkonte rrugët e Kudamm-it në Berlin si shitëse gazetash. Djuna Barnes, mikja e saj, i dërgonte asaj paketa me rroba, libra dhe para. Gjithashtu e në këtë mjerim që nga larg e ndihmonte atë edhe Peggy Guggenheim, koleksioniste e artit dhe financuese. Në korrik 1924 mori një vizë në ambasadën franceze, ku shkoi atje me një kek dhe një qiri të ndezur mbi kokë. Por, pas një sulmi hajdutësh u gjend në shtëpi e frikësuar. Nga kjo ngjarje pësoi një goditje psikike, andaj u dërgua në një institucion kurimi. Pasi doli që andej, plotësisht e varfëruar, u ndihmua sërish vetëm nga miket e saja.

Në vitin 1926 u nis për në Paris, ku takoi Djuna Barnes dhe surrealistin Mary Reynolds. Aty hapi një shkollë për modele, por pas dy muajve u detyrua ta mbyllte. Në fund të jetës së saj të larmishme dhe të zhurmshme mbretëresha e çmendur Dada u gjend e vetmuar, e varfër dhe depresive.

Siç shfaqet dhe në këtë historik të saj, Elsa von Freytag-Loringhoven ka qenë tri herë e martuar: Kurora e parë (1901) me arkitektin e stilit Jung me August Endell, kurora e dytë me (1910) përkthyesin Felix Paul Greve, martesë e tretë (1913) me Leopold Karl Friedrich Baron von Freytag-Loringhoven (1885–1919).Që të treve ajo i kushtoi nga një poezi të gjatë. Meqenëse për një kohë të gjatë media nuk ishte në gjendje të pasqyronte këtë dinamikë të saj, shkoi gjithashtu edhe më gjatë që gjenialiteti i saj të bënte jehonën e duhur.

Tashmë gjendet një biografi e saj e botuar që të paktën e plotëson dhe e bën të njohur jetën e divës Dada. Pas shumë kohësh suksesi i saj është i vërtetuar, që Baronesha Else Hildegard Plötz e lindur Else Hildegard

Plötz me 1874, e njohur me emrin Mama Dada, apo Dada Baronesha, ishte një artiste e vërtetë, e cila që herët shfaqti një fuqi shprehëse që ia demonstronte trupin, elasticitetin e trupit të saj, mimika e fytyrës dhe veshja.

Herë shfaqej me sytjenin e krijuar nga tubeti i salcës së domateve, e herë me konservën e sardeleve, apo me një kovë mbi kokë si helmetë, apo me kapuçin e pilotit dhe me rrathë celuloidi në krahë. Herë të tjera shfaqej me një kokë të rruar plot shkëlqim dhe të llakosur, me një top baseball-i për qafë, sikur të ishte një kolanë për fyt, me një çorape të verdhë dhe një të zezë, me një kapak kove qymyri si helmetë dhe me një qen të lidhur me një rrip të kuq. Prezantonte Hamletin në gjermanisht me një kokë të një perandori romak me sy të gjelbër shpues, me një zë të ashpër, që sikur vinte nga një vend i shkretuar. Në këtë kohë në Gjermani nuk kishte aspak vend për një femër që nuk dëshironte aspak të ishte një objekt dhe frymëzim i fshehtë. “Femrat frymëzuese këtu mund të vepronin vetëm në mënyrë të kufizuar.” Vetëm në Boheminë shumkulturëshe të Greenwich Village kishte hapësirë të lirë mendimi për artin eksperimental të baroneshës. Problemi i Elsës kishte një ecure të vështirë në karrierën e saj drejt feminilitetin ekstrem kur në fakt në tregun e artit dominimin burrat. Madje edhe Nju Jorku kapitulloi së fundi përpara skandaleve të baroneshës. Vetë Jane Heap, që financonte “*Little Review*”, nuk paraqitej më shumë këmbëngulës për atë. Një arsye për këtë nuk ishin vetëm meshkujt, të cilët kishin frikë përpara fuqisë dhe mendjelehtësisë të fisnikëve. Kishte letra kërcënuese, telefonata, nofka, fyerje dhe sulme, me të cilat baronesha ndeshej vazhdimisht. Dada Baronesha, Elsa von Freytag-Loringhoven ishte një artiste gjeniale dhe një legjendë nervore e madhe.”

Ajo dëshironte të kapërcente kufijtë e seksualitetit të saj. Dhe këtë donte ta bënte jo vetëm nga dëshira dhe etja për liri. Elsa kishte një trup androgjen, loja e saj me ideologjinë e gjinive dhe qejfi ekspresiv frymëzoi një mori artistësh pas lufte. Pikërisht ky ishte thelbi i artit të saj pas lufte. Ajo është modeli, muza, pararendësja e revolucionit erotik në fillim të shekullit të 20-të. Baronesha njihet si Dada e parë amerikane.

Elsa von Freytag-Loringhoven vdiq në moshën 53 vjeçare me 14 dhjetor 1927, në banesën e saj në Paris nga asfiksioni me gaz. Bashkë me të vdiq edhe Pinky, qeni Dada shumë i dashur i saj, si dhe shumë kafshë të dashura të saja që i mbante në shtëpi.

Mikesha e saj e ngushtë Djuna Barnes e quajti vdekjen e saj: “Një shaka e çmendur që asesi nuk mund të përmbante një veprim dashakeq dhe të qëllimshëm.”

Nëse ishte një aksident, vetëvrasje, apo një krim i kryer me qëllim, kjo nuk u zbulua kurrë. Mbeti enigëm, ashtu siç ishte tërë jeta saj, që vërtet ishte e kredhur në enigëm.

Përgatiti HAXHIRE LULI





Salman Rushdie

SHKRUAJ PËR LEXUESIT, JO PËR KRITIKËT

S'mund t'ia lejojsh vetes të mendosh për kritikën kur po shkruan librin. Është tepër e vështirë ta shkruash librin dhe në të njëjtën kohë, të rrekesh të hamendësosh si do të jetë reagimi kritik ndaj tij. Por them se i përfytyroj mjaft mirë lexuesit e mi. Ndërsa vitet mbi supe më shtohen, interesohem gjithnjë e më shumë për mënyrën se si lexojnë njerëzit, çfarë ka të ngjarë t'i largojë dhe t'i tërheqë. Jam bërë më i vetëdijshëm për lexuesin. Them se kur isha më i ri thjesht shkruaja; nëse lexuesit shfaqeshin diku, shumë mirë, nëse jo, s'prishte punë. Kam pasur një lloj qëndrimi shumë më të ashpër. Por tani jam vërtet i interesuar të lexohem, për dukurinë e leximit dhe si, nëse informacionin e jep në rendin e saktë, mund të tregosh gjëra shumë të ndërlukuara, të cilat për lexuesin bëhen të rrokshme, kanë lidhje me ta dhe u ngjallin dëshirën për t'i zbuluar. Për shembull, në rastin tim, gjithmonë kam menduar që komedia ndihmon shumë. Mendoj se nëse arrin t'i bësh njerëzit të qeshin, mund t'u thuash gati çdo gjë. Nëse s'i bën dot të qeshin, s'do

të duan të të dëgjojnë për një kohë të gjatë. Kjo është e para. Por për kritikët, për një lloj reagimi kritik ndaj asaj që shkruaj, s'mendoj dot. Dua të them se në këtë moshë kupton se ka njerëz që s'do ta pëlqejnë çfarëdo që të shkruash.

Kësisoj, e dija që mund të shkruaja librin më të mirë që mund të shkruaj dhe sërish do të kishte disa që thjesht s'do ta pëlqenin, dhe s'ka gjë për t'u çuditur këtu. Kjo është arsyeja pse në librari ka lloje të ndryshme librash, që njerëzit të zgjedhin atë që u pëlqen. Prandaj s'më shqetëson kjo. Përnjëmend s'më shqetëson reagimi i kritikës. Kur ke shkruar disa libra, e ke të qartë drejtimin nga do të shkosh. Këndvështrimi im është: tani për tani do të shkoj në këtë drejtim dhe vërtet shpresoj se dëshironi të vini me mua. Shpresoj ta shijoni udhëtimin dhe kështu me radhë, por nëse, për çfarëdo arsyeje, s'mund të më shoqëroni në këtë udhëtim, unë do të vazhdoj të ndjek rrugën time. Dhe atëherë merr me vete kë të mundesh në këtë arrati. Mendoj se, në përgjithësi, kam pasur goxha

shumë shoqërues gjatë arratisjeve të mia. Mund të parashikoj se kur ndodh aksident me kritikën letrare gjatë udhëtimit, sepse e marr me mend, por në njëfarë mënyre kjo s'ka rëndësi.

Dua të them, mbaj mend që në një lloj epoke të parainternetit kishte një kohë kur revista të ndryshme letrare përdorëshin për të botuar recensione në mënyrë anonime dhe më e famshmja *Times Literary Supplement* s'i përmendte kurrë emrat e kritikëve të saj. Ideja ishte që të krijohej përshtypja që ishte *Times* që po jepte mendimin e saj për veprën tënde dhe jo një individ. Dhe pastaj në kohë tjetër, them se diku në vitet 1980, kjo politikë u ndryshua duke vënë emrat e kritikëve. Menjëherë vlerësimet u bënë shumë më të matura, sepse emri i kritikut i bashkëngjitej kritikës letrare.

S'ka dyshim se mënyra si jetojmë me internetin është gjysmë imagjinare. E para, njerëzit përdorin emra të rremë gjatë gjithë kohës, përdorin vazhdimisht pseudonime dhe për këtë arsye, mund të shpikin vetveten për të qenë në internet pa i pyetur se kush janë. Mendoj se kjo mund të jetë e mirë dhe e keqe. E shoh qartë se çfarë ndodh në pjesë të botës që janë shoqëri më pak të hapura, që anonimati i lejon njerëzit të shprehen pa frikë. Dhe mendoj se ka një lloj lojçakërie në këtë. Shpik për veten një emër të çmendur dhe mbase mund të jesh një person pak më ndryshe me atë personalitet sesa të mundesh të jesh si vetvetja. Kështu, ka shumë për të thënë për këtë çështje. Dua të them se më pëlqen shumë lojçakëria dhe një lloj aspekti çlirues i saj.

Një lloj shqetësimi që kam për disa përdorues anonimë të internetit është se kjo krijon deri diku dukurinë e karremit. Duke qenë plotësisht i sigurt pas ekranit të emrit imagjinar, ti mund të jesh shumë, shumë i pasjellshëm. Kam frikë ndonjëherë se po bëjmë të mundur të kemi një brez njerëzish shumë të vrazhdë që mund të flasin në internet në një mënyrë që kurrë s'do të flisnin nëse do të ishin në dhomë me ty. Ky është shqetësimi im. Por mendoj se, në përgjithësi, është një hapësirë e gjallë. Është një hapësirë ku njerëzve u pëlqen të jenë shpikës dhe imagjinues për veten e tyre dhe teknologjia u lejon ta bëjnë këtë.

2019

SHËNIME PËR LETËRSINË DHE KOMBIN


*Mëllenja po këndon Cilgëri te pyllishta
Pa pushim si rrjedha mbi gurët e myshkëta
S'është aq e moçme sa thithëlopa e Cors Fochno-s
Me lëkurën e ngjitur në kocka.*

1

Pak shkrimtarë i këndojnë me kaq pasion tokës së të parëve të tyre sa R. S. Thomas-i, një nacionalist uellsian i cili, me anë të poezive që sjellin në vëmendje, pohojnë, kthehen në rapsodi, krijojnë mite, kërkon të shkruajë për kombin si qenie e ashpër lirike. Megjithatë, është po ky R. S. Thomas, i cili po kështu shkruan:

*Urrejtjes i duhet një kohë e gjatë
për t'u rritur dhe kjo imja
ka nisur të rritet qysh kur linda;
S'ushqehet nga toka mizore,
por prorre
e kam për veten k'të urrejtje, është imja*

Është befasuese të shohësh se sa hapur pranohet diçka e përafërt me urrejtjen për veten në vargjet e një bardi kombëtar. Por ndoshta vetëm kështu mund të shkruajë një shkrimtar nacionalist. Kur imaginata merr dritë nga pasioni, atëherë ajo sheh errësirën ashtu si dhe dritën. Të ndiesh në mënyrë kaq të egër, do të thotë të ndiesh njëherazi përçmim dhe krenari, urrejtje dhe dashuri. Ky përçmim krenar, kjo dashuri urrejtëse, shpesh ngjallin ndaj shkrimtarit zemëratën e kombit.



Kombi kërkon himne, flamuj. Poeti të jep paqetësi. Zhele.

2

Ekzistojnë lidhje mes zhvillimit historik të “narrativës” binjake të romanit dhe shtetit-komb. Shtjellimi i një rrëfenje në fletën e bardhë drejt synimit të fundmë ngjan me imazhin që ka për veten një komb, që përshkon historinë për të përmbushur fatin e tij të paracaktuar. Pavarësisht sa tërheqës mund të jetë një paralelizëm i tillë, unë e shoh atë me shumë rezerva. Njëmbëdhjetë vjet më parë, në kongresin e famshëm të PEN në Nju-Jork, shkrimtarët e botës diskutuan “Imagjinatën e shkrimtarit dhe imagjinatën e shtetit”, një temë e cila ka shkëlqimin e temës së parapëlqyer të Norman Mejlërit, një vizion që pa dyshim ai e ka pasur kur shkruante.


Është e habitshme se në sa mënyra mund të interpretohet kjo “dhe” në titullin e konferencës. Për shumë nga ne, do të thotë “kundër”. Shkrimtarët afrikano-jugorë, Gordimer-Coetzee, në kohën e aparteidit u rreshtuan kundër përkufizimit zyrtar të kombit, duke e shpëtuar ndoshta kombin e vërtetë nga ata që e kishin marrë peng. Xhon Apdajk krijoi një himn lavdëruar për kutitë e vogla postare të Amerikës, të cilat për të ishin emblema të përhapjes së lirë të ideve. Danilo Kiš na ka dhënë një shembull “të shakasë” që ka bërë me të shteti: një letër që ai mori në Paris, ishte nisur nga ajo që atëherë quhej Jugosllavi. Brenda zarfit të vulosur, në fletën e përparme të zarfit, ishte stampuar fjalia: “Kjo letër është e pacensuruar.”

3

Kombi ose bën pjesë të tij shkrimtarët e vet më të mëdhenj (Shekspiri, Göte, Tagore) ose kërkon t'i shkatërrojë ato (ekzili i Ovidit, ekzili i Soyinka-s). Këto fate nuk janë kaq të ndara nga njëri-tjetri. Mosnderimi i shkrimtarëve nuk është i denjë për letërsinë; shkrimtarët e mëdhenj shkaktajnë trazim në mendje dhe në zemër. Ka nga ata që besojnë se persekutimi është diçka e mirë për shkrimtarët. Kjo nuk është e vërtetë.

4

Kini parasysh shkrimtarin që e shih veten si zëri i një kombi. Bëhet fjalë për kombin e racës, gjinisë, orientimit seksual. Kjo është rryma e re e të “të folurit në emër të...”. Kini parasysh ata që flasin në emër të...



Kjo rrymë e re kërkon, lartësohet, thekson pozitiven, paraqet udhëzime turbulluese morale. Tmerrohet nga kuptimi tragjik i jetës. Ta shohësh letërsinë si pashmangshmërisht politike, do të thotë që vlerat politike të zëvendësojnë vlerat letrare. Kjo e vret mendimin. Kini kujdes!

5

Po ju them që pasaporta ime është jeshile. Amerika po vë shpatullat e mia të hajthme në rrotën e historisë. Për të farkëtuar çelikut e shpirtit tim, ndërgjegjen e pakrijuar të racës sime. Shqipëria e Kadaresë, Bosnja e Ivo Andriçit, Nigeria e Achebe-s, Kolumbia e Garzía Markezit, Brazili i Jorge Amado-s tregojnë që shkrimtarët e kanë të pamundur të mohojnë ngadhënjimin e kombit, shkollat e tij në gjakun tonë. Shkrimësia si harta e një vendi: si hartografi e imagjinatës. (Ose siç mund ta shkruajë teorika moderne kritike sot, “Imagi/Nation”). Në shkrimet më të mira, sidoqoftë, harta e një vendi është harta e botës.

6

Historia është bërë e diskutueshme. Si pasojë e Perandorisë, në epokën e superfuqisë, pas “gjurmëve” të thjeshtëzimeve që na japin satelitët, zor të biem dakord për thelbin e debatit, e jo më për kuptimin e tij. Letërsia bëhet pjesë e këtij qarku. Historianët,

zotët e medias, politikanët, nuk e vrasin mendjen për ndërhyrjen e bezdisshme të letërsisë, por ky i paftuar është kokëfortë. Në këtë atmosferë të paqartë, mbi këtë tokë të nëpërkëmbur, në këto ujëra të pista me baltë, letërsia ka lëndën e saj të parë.

7

Nacionalizmi po kështu mund t'i korruptojë shkrimtarët. Të tilla ishin ndërhyrjet helamtisëse të Vide Limonovit për luftën në ish-Jugosllavi. Në kohën e nacionalizmave në kuptimin më të ngushtë të fjalës, në kohën e nacionalizmit si thirrje për luftë e fisit, shkrimtarët mund ta gjejnë veten duke shqiptuar këto klithma lufte të fiseve të tyre. Sistemet e mbyllura kanë tërhequr gjithmonë vëmendjen e shkrimtarëve. Kjo është arsyeja pse është shkruar kaq shumë për burgjet, forcat policore, spitalet, shkollat. A është kombi një sistem i mbyllur? Në këtë moment të ndërkombëtarizimit të gjithçkaje, a ekziston ndonjë sistem që mund të mbetet i mbyllur? Nacionalizmi është “revolta ndaj historisë”, e cila kërkon të mbyllë atë që nuk mund të mbahet më e mbyllur. Të vendosë kufij tek ajo që duhet të jetë pa kufij. Letërsia e mirë shkruan për një komb pa kufij. Shkrimtarët që kanë shkruar për ekzistencën e kufijve janë shndërruar në roja kufiri.

8

Nëse shkrimësia kthehet në mënyrë të përsëritur te kombi, ajo po ashtu në mënyrë të përsëritur largohet prej tij. Qëllimisht çrrënjësia intelektuale (Naipaul) e shih botën si një inteligjencë të lirë, duke shkruar atje ku është veprimi dhe duke ofruar raporte. Intelektuali, qëllimisht i paatdhe (V.S. Naipaul), e shih botën ashtu si mund ta shohë një njeri me inteligjencë të lirë, duke dëshmuar ngjarjet ashtu si ndodhin. Intelektuali i paatdhe, kundër vullnetit të tij (një kategori shkrimtarësh në të cilën bëjnë pjesë shumë shkrimtarë të shkëlqyer arabë), refuzon mbylljen në një rreth refuzues për të. Një paatdhësi e tillë përbën një humbje dhe mall të madh. Por edhe fitore. Kombi pa kufij nuk është fantazi.

9

Një pjesë e madhe e letërsisë së epërme nuk ka nevojë për përmasën e të qenit publik. Agonia e saj vjen nga brenda. Sfera publike s'është asgjë, ashtu siç nuk ishte për shkrimtaren amerikane Elizabeth Bishop. Burgu-liria-lënda e shkrimësisë është diku tjetër.

Nina nana.


Kombet zemërohen,

Shuhen si të mos ishin kurrë.

Hija e koçekut të misrit një kafaz i madh

mbi mur.

Përktheu: Granit Zela



POEZIA / BASHKËKOHORE SHQIPE

ZEF
SKIRO
DI MAXHO

PO EMA ARBE RE SHE



POEMI ARBERISCHI
GIUSEPPE
SCHIRÒ DI MAGGIO



OMBRA GVG
www.ombra-gvg.it